

# KONFLIKTET E BESIMEVE, IDEALEVE DHE PIKËPAMJEVE TË NDRYSHME

(Analiza e dramës poetike “Samson Agonistes” të Xhon Miltonit)

Lirak KARJAGDIU<sup>1</sup>

Adresa: Rr. “Agim Ramadani”, Aktash A/1, nr. 35

Mob.: 044/183-265

<sup>1</sup>E-mail: lirak.karjagdiu@uni-pr.edu

## ABSTRAKT

Në këtë punim janë shqyrtuar dhe përimituar karaktersitikat kryesore të pjesëve përbërëse të dramës poetike “Samson Agonistes” dhe veprës së fundit të shkrimtarit famëmadh anglez, Xhon Miltonit. S’ka pikë dyshimi, se “Samson Agonistes” është një dramë e njëmendët me sfondin, atmosferën, fabulën, personazhet e vërtetë dhe dialogjet e monologjet dhe ka karakter autobiografik. Ajo madje mund të përgatitet e të shfaqet me sukses para publikut. Te drama “Samson Agonistes” Miltoni i përvishet një teme individuale, vitale dhe mitologjike. Ai nisët nga legjenda dhe kallëzimi biblik dhe me një frymëzim të veçantë poetik e elaboron në detaje tregimin për mbrojtësin e fuqishëm të Izraelit, Samsonin, i cili kishte rënë në duart e armiqëve të tij më të pabesë për shkak të një dobësie dhe mëkati të pasionit, ishte verbuar dhe përbuzur dhe ishte shtrënguar të punonte si rob për filistinët. Në këtë kontekst, në këtë punim janë përimituar temat, motivet, vargu i ngjarjeve të fabulës, veprimet dhe konfliktet më të rëndësishme, protagonistin Samson dhe antagonistin Dalila, personazhet tjerë të dorës së dytë Manoa, i ati i Samsonit, Harafa, Kapadaiu dhe provokatori vigan filistinë, Lajmëtari i mbretit, Kasneci izraelit, Kori, si dhe stili dhe mesazhi i veprës. Veç këtyre, janë hetuar, interpretuar dhe komentuar edhe veçoritë më tipike të kësaj drame me elemente të dramës klasike dhe biblike nën ndikimin e të cilëve ka qenë autori i kësaj vepre dramatike dhe poetike.

**Fjalët kryesore:** *Drama poetike “Samson Agonistes”, analiza, konfliktet, temat, motivet, personazhet, tradita klasike dhe biblike.*

## 1. Tema dhe fabula e dramës “Samson Agonistes” të Miltonit

Një ndër kryetemat e kësaj tragjedie miltoniane është paraqitja dhe trajtimi i tundimit, ose i sprovimit, sepse në këtë vepër sfidohet po edhe dërrmohet dobësia njerëzore. Veç kësaj, një temë tjetër e kësaj vepre është edhe triumfi moral dhe mbijetesa e besimit dhe e idealit, sepse te “Samson Agonistes”, si jeta ashtu edhe vdekja e heroit kryesor, përfshin si rënien në mëkat ashtu edhe shëlbimin ose këndelljen shpirtërore.

Me pak fjalë, Samsoni dështoi dhe gaboi në misionin e tij, duke mos e përmbajtur ambicien dhe epshin, kështu që me mendjelehtësi ra në kurthën djallëzore. Ndërkaq, pasuan disfata, robëria dhe vuajtja. Ai ia doli mbanë të mëkëmbej, të këndellej dhe të ngjallej shpirtërisht dhe fizikisht, duke u bërë ballë sfidave, provokimeve dhe tundimeve të ndryshme. Veç kësaj, gjatë vuatjeve, brengave dhe telasheve që pati, ai kurrë nuk i fajësoi të tjerët, po veten, i vetëdijshëm se e kishte merituar dënimin e robit e të Zotit. Duke rezistuar ndaj sfidave të shumta, të botës e të shpirtit të

vet, Samsoni u kthjellë dhe u ringjallë dhe e sëndërtoi pikësynimin e jetës së tij përmes një vdekjeje të frymëzuar nga fuqia hyjnore.

### 1.1. Episodet kryesore

Poema fillon me një prolog dhe vargun 114 të monologut të Samsonit. Më pas, vazhdon me një parodos në vargun 61 të Korit para se t'i drejtohet Samsonit. Dialogu në mes të Samsonit dhe Korit (vargjet 176-292) është episodi i parë që vazhdon me **stasimon** e parë, ose odin koral (vargjet 293-325). Kori mbetet gjatë tërë kohës në skenë dhe komenton secilën episodë me një **stasimon**, përveç rolit që ka, për të marrë pjesë në dialogje të caktuara. Episodi i dytë fillon me ardhjen e Manoas (vargu 326). Episodi i tretë është takimi i Samsonit dhe Dalilës (vargjet 710 - 1009). I katërti është ai i bisedës në mes të Samsonit dhe Harafës. Episodi i pestë bën fjalë për dy vizitat e të dërguarve filistinë dhe përfundon me shkuarjen e Samsonit në Festivalin e Dagonit dhe vdekjen e tij (vargjet 1301-1426). Kur Manoa hyn përsëri, fillon eksodi ose epilogu i dramës (vargu 1441) dhe vazhdon deri sa Lajmëtari nuk e kumton lajmin për vdekjen e Samsonit. Drama përmbyllet me komentet e Korit dhe Manoas që quhen **komos** (vargjet 1660-1758).

Fakti se Miltoni i referohet tre dramaturgëve të mëdhenjë të Atikës si dhe analiza e kësaj tragjedie, provojnë se ai nuk e imiton asnjë dramaturg dhe aq më pak ndonjë dramë. Duhet theksuar se pjesëve të dramës “Samson Agonistes” mund t’u jipen emra grekë, ngase është e qartë se janë ndërtuar sipas parimeve greke. Por është poaq me rëndësi të kuptohet se Miltoni ka lejuar që subjekti dhe koncepti i domethënies së tij, të kenë ndikim vendimtar në formën përfundimtare të dramës.

Tregimi mbi Samsonin gjindet në “Dhiatën e vjetër”, në Librin e “Gjyqit të fundit”, kaptinat XIII-XVI. Duke zgjedhur për shtjellim dramatik fazën e fundit të jetës së Samsonit, Miltonit iu desht që të sajojë dhe trillojë një sërë aksionesh, veprimesh dhe diskutimesh të shkurtëra, në kuadrin dhe sistemimin e fabulës. Argumenti bën fjalë pikërisht për këto<sup>1</sup>. Anipse prezantohen vetëm disa orë para vdekjes së Samsonit, poema në përgjithësi përmes ligjit të retrospektivës i referohet dhe merret me të gjitha ndodhitë dhe episodet e jetës së Samsonit. Por, Miltoni eviton ca detaje nga jeta e tij, të cilat mbase mund t’ia ulin vlerën dhe rëndësinë Samsonit si hero tragjik. Fjala vjen, ai nuk bën fjalë fare për hakmarrjen e Samsonit ndaj filistinëve, kur ai u vë zjarrin të korrave të tyre. Ai vetëm kalimthi bën fjalë për këtë enigmë dhe për marrëdhëniet e Samsonit me gruan nga Timnahu. Duke e shpërfillur deklaratën sipas së cilës Samsoni e konsideronte dhe e shihte Izraelin si vendin e epokës së filistinëve para njëzet vitesh, ai e ka paraqitur heroin më të vetmuar dhe më të pavarur. Duke e paraqitur Manoan si një burrë të kamur, ai ka bërë të mundur që ai të ketë një rol të rëndësishëm gjatë ditëve të fundit të jetës së Samsonit dhe njëherësh ia ka shtuar origjinalitetin dhe dinjitetin rrëfimit, konform pikëpamjes aristoteliane dhe të Renesansës, sipas së cilës tragjedia duhet t’i përshkruajë marrëdhëniet e personazheve kryesore. Modifikimet dhe ndryshimet e tilla pajtohen me ato të praktikave antike greke. Kështu publiku në Greqinë antike, e kishte të njohur përmbajtjen e fabulës që prezantohej dhe së këndejmë, e dinte se çfarë përfundimi të priste në secilën fazë<sup>2</sup>. Mirëpo, dramaturgut i lejohej, madje edhe kërkohet nga ai, që të krijojë versionin e tij të ngjarjeve si dhe vizionin dhe pikëpamjen e tij të domethënies së tyre.

### 1.2 Prologu

Hyn Samsoni, të cilin e ka zënë për dore dhe i prin një fëmijë, të cilit i flet Samsoni, kurse fëmija në heshtje largohet prej tij. Pastaj, Samsoni në një monolog të gjatë i përmend elementet kryesore të situatës dramatike. Ai po ashtu, është i vetëdijshëm se me rastin e festës së filistinëve për nder

të Dagonit, ai do të përfitojë nga rasti për të përsiatur. Samsoni e përshkruan shqetësimin e tij shpirtëror, prej të cilit s'ka si të shmanget dhe e krahason atë me premtimet që ishin bërë para lindjes së tij si dhe këshillat që u kishin dhënë engjujt prindëve të tij, për ta rritur dhe edukuar ate si të përzgjedhur të Perëndisë, të cilin e prisnin detyra të mëdha, në altarin e atdheut. Ai nuk e kuptonte se përse i ishin dashur gjithë ato përgatitje nëse do të dështonte. Mirëpo, Samsonit i kujtohet se vetë sjellja e tij kishte qenë shkak për dështimin e profecisë. Dobësia e vullnetit të tij, të cilën ia zbuloi gruas së vet, tregon se sa e padobishme mund të jetë fuqia fizike pa mençuri. Dhurata e fuqisë, të cilën ia kishte falë Zoti atij nuk kishte ndonjë vlerë të madhe, meqë varej prej një cikërrimi, prej flokëve. Ai me këtë rast, dyshon në drejtësinë e Zotit, mirëpo ankohet se fuqia e tij kishte qenë një dhuratë fatale, sepse për pasojë kishte pasë pësime dhe shkatërrime, kurse pasojën më të fatale e kishte pasë humbjen e të pamurit. Në pjesën tjetër të monologut të tij, ai i përshkruan të këqijat e verbërisë, të cilat ia shtojnë aq tepër vuajtjet. Si më parë, ai ka mëdyshje në mençurinë dhe drejtësinë e Perëndisë, duke pyetur se pse nëse drita është një gjë aq e nevojshme dhe e bekuar, njeriu mund të mbetet fare lehtë pa të. Me tronditjen gjithnjë e më të madhe të Samsonit, ankesa e tij merr nuancë lirike. Por, me të dëgjuar afrimin e Korit ai ndërpret përsiatjet nga frika se mos ishin duke ardhur filistinasi. Ky fjalim i gjatë, i cili është një lloj prologu, nga një anë i qet në shesh të dhënat kryesore për gjendjen në të cilën ndodhej Samsoni, kurse nga ana tjetër e pasqyron edhe gjendjen shpirtërore të tij. Ate e kanë pushtuar dyshimet dhe e bren ndërgjegjja. Megjithatë, ai nuk e mohon përgjegjësinë e tij për dështimin dhe fajin e bërë, prandaj duke dalluar të mirën dhe të keqen ai nuk reagon kundër Zotit<sup>3</sup>.

### 1.3. Episodi i parë

Tani kjo pjesë në fillim, sipas parimit të dramës antike greke quhet parodos dhe këtu rolin kryesor e luan Kori<sup>4</sup>. Në skenë hyn Kori, ndonëse nuk i afrohet tepër Samsonit. Kori komenton situatën e rëndë në të cilën ishte katandisur Samsoni, duke e krahasuar gjendjen e tij me fuqinë e mëparshme dhe aktet e lavdishme të tij. Kori shfaq keqardhje dhe mëshirë për shkak të dobësisë, robërisë, verbërisë dhe të fatkeqësisë së Samsonit. Kjo rënie nga një gjendje shumë e mirë dhe nga fama, i ka ndodhur një njeriu vërtetë të madh, madhështia e të cilit nuk mbështetej as në trashëgiminë e as në privilegje. Përmbajtja e porosisë së Korit është pak a shumë e ngjashme me monologun e Samsonit. Miltoni e përdorë Korin me qëllim që të zgjasë dhe të intensifikojë ndjenjën e monologut të mëparshëm.

Në episodin e I-rë Samsoni çuditet, për arsye se ndërsa i dëgjon zërat, nuk i dëgjon dot fjalët si duhet. Prandaj, Kori i afrohet Samsonit dhe e paraqet veten si një grup i miqëve, fqinjëve, dashamirëve dhe shokëve nga fisi i Danit, të cilët kanë ardhur t'ia qajnë hallet dhe brenda mundësive edhe ta ngushëllojnë. Samsoni i pret me kënaqësi si miq të njëmendët, ngase ata janë treguar miq të vërtetë kur ai kishte nevojë për ta dhe pranon se i vinte turp për marrëzinë e bërë në të kaluarën. Mirëpo, ai shfaq edhe dilemën sepse nuk e dinte as vetë se a ishte gabim i tij që Zoti i tij i kishte dhënë aq fuqi, por pak mençuri. Kori ia ndalon që ta qortojë Provaninë dhe parshikimin e Zotit, duke shtuar se ka edhe njerëz të tjerë të mençur të cilët janë mashtruar nga gratë. Mirëpo, vazhdon Kori, ç'është e vërteta, miqtë e tij nuk kuptojnë se si Samsoni vendosi të martohej me një grua filistine, në vend se të merrte një grua nga populli dhe feja e tij. Nga ana e tij, Samsoni përgjigjet se të dy martesat e tij ishin të parashikuara nga Zoti dhe se Zoti i Madh kishte pasur parasysh se Samsoni do të ngrihej kundër filistinëve, shtypësve të popullit të tij. Fundja, Dalila nuk ishte shkaku kryesor i mëkatit të tij, por ishte vetë Samsoni.

Kori, ndërsa nga një anë e lëvdon gatishmërinë e përhershme e të pakursyeshme të Samsonit për çështjen e atdheut, nga ana tjetër thekson se megjithatë, ai nuk ia kishte dalur mbanë që t'i

çlironte izraelitët nga sundimi filistinëve. Për këtë arsye, përgjigjet Samsoni, prijësit izraelitë duhet ta pranojnë fajin e tyre, sepse nuk i ndihmuan atij gjatë luftimeve të tij me armikun; bie fjala, fisi i Judës nuk i erdhi në ndihmë atij në Etam dhe as që e shfrytëzoi rastin për t'i sulmuar filistinët, pasi Samsoni i kishte mposhtur ata vetëm në Ramath - Leçi. Mirëpo, kjo gjyqësi e mefshtë dhe meskine është karakteristikë e popujve, të cilët janë çoroditur në robëri. Popujt e tillë janë të gatshëm për t'i tradhëtuar ata të cilët përpiqen për çlirimin e tyre. Kori është dakord se izraelitët kanë vepruar shpesh në këtë mënyrë ndaj mbrojtësve të tyre më të shquar. Atëhere, Samsoni pohon se populli mund t'ia shtojë rastin e tij rasteve të tjera (d.m.th se kjo është vetëm një rast që i shtohet rasteve të tjera), jo për arsye se fati i tij është i rëndësishëm, po për shkak se duke mos e përfillur atë, populli e ka flakur ofertën e Zotit për çlirimin e vet.

#### 1.4. Episodi i dytë

Në vazhdim Kori mbetet në skenë dhe komenton këtë episod ose stasimon. Kori shpall se në drejtësinë e Zotit nuk mund të dyshojë asnjëri pa gabuar dhe mëkatuar. Meqë, Zoti është i pafund dhe i paanë, Perëndia nuk është i obliguar të ketë ligje dhe adresa të veçanta për njerëzit. Ai mund të kursejë atë që ka vendosur ta kursejë, dhe ta çlirojë nga ligji që ndalon martesën midis izraelitëve dhe pjesëtarëve të popujve të tjerë, ashtu si i kishte lejuar Samsonit për të marrë një grua nga Timnahu, ndonëse ky vendim kishte qenë në mospajtim me betimin e Samsonit për të ruajtur dëlirësinë e tij si një nazarit apo i zgjedhur i Zotit. Arsyeja duhet të vihet nën kontrollë, sa herë që është fjala për ligjet e Zotit: Megjithëse, Kori ve në dukje se gruaja e parë e Samsonit “ishte e papastër”, vetëm sipas ligjit të Moisiut, nga ana tjetër ajo nuk kishte faj në kuptimin moral të fjalës, ndaj pandershmëria e saj pas martesës nuk ka ndonjë ndikim në vendimin e drejtë apo të gabuar të tij. Me paraqitjen e Manoas, Kori e ndërpreu fjalën.

Me të hyrë Manoa ankohet për fatkeqësinë e të birit, dhe ka dëshirë për ta qortuar atë për shkak se i kishte inkurajuar armiqtë e Zotit. Samsoni përsëri e pranon përgjegjësinë e tij për fajin e bërë dhe shton se ai i ka bërë të mundur armikut që të ngadhënjë Perëndia i filistinëve. Mirëpo, ai po ashtu thotë se Zoti i vërtetë, i cili do të dalë ballë për ballë me Dagonin, do të tregojë epërsinë e fuqisë së tij. Manoa e njofton të birin se është duke biseduar me disa krerë filistinë me qëllim që ta nxjerrë nga pengu e ta lirojë me shpërblese Samsonin, por ky i fundit thotë se më “me dëshirë do të vuante dënimin që e meriton se sa të lirohej me shpërblese”. “Pse të lakmoj për të jetuar edhe më tej?”, e pyet veten ai, pasi iu ka errësuar fama dhe është katandisur keq. Me këtë rast, ndërhyr Kori për ta ngushëlluar atë duke e lavdëruar përkorinë, ndershmërinë dhe maturinë e tij në të kaluarën, por Samsoni thekson se abstenimi nga mospirja e verës nuk kishte qenë aq me rëndësi, sepse ai nuk e përmbajti veten nga epshi seksual, që e mori në qafë atë. Manoa kërkon nga ai, që mos ta përdorë fuqinë e tij të përtrirë për t'i shërbyer armiqtë e Zotit. Manoa shpreson se nëse Samsoni pranon të lirohet me shpërblese, Zoti mund t'ia kthejë të pamurit, duke i dhënë rast atij që të bëjë vepra të tjera heroike. Por, Samsoni ndien se një gjë e këtillë është e pamundur, sepse jeta e tij aktive kishte përfunduar, kurse vdekjen e kishte afër. Manoa mbetet i pakënaqur dhe largohet i pabindur për të përfunduar marrëveshjen për lirimin e të birit me shpërblese. Ndonëse Samsoni e dënon fajin e vet dhe pasivizohet deri diku, ai beson se Zoti do të ngadhënjë, sepse në dramë zakonisht është e ditur se parashikimet ose sëndërtohen ose pengohen.

Në këtë poemë kur shkalla e emocionit intensifikohet, vargjet e bardha shndërrohen në vargje lirike. Kështu, kur Manoa largohet nga Samsoni, në një monodi shpreh torturat e tij mendore dhe humbjen e shpresës së tij. Vizita e Manoas dhe biseda me të, kanë shkaktuar një shkurajim të madh tek ai.

## 1.5. Episodi i tretë

Fillon me vërejtjet e Korit dhënë Samsonit të zhgënjyer. Kori i bën vërejtje Samsonit se është e kotë që të ngushëllohet një dhimbje e thellë nëpërmjet përsiatjeve morale dhe se vetëm Zoti mund të ngushëllojë një shpirt të bjerrur ose të braktisur. Kori pyet pse Zoti sillet me rreptësi me krijesat njerëzore dhe me krijesat tjera nën njeriun dhe pse ndryshon fati aq shpesh. Ai s'di pse nuk vuajnë vetëm njerëzit e zakonshëm dhe të thjeshtë, por vuajnë edhe ata të cilët Zoti i ka përzgjedhur dhe nderuar si shërbëtorë të vet. Fati përfundimtar i krijesave të zgjedhura shpeshherë është aq i keq saqë duket se nuk kanë merituar fat më të mirë, por e kanë fatin e njëjtë si të tjerët. Kori e lut Samsonin që mos të mbetet i katandisur në atë mjerim dhe uron që mendja e tij të kthjellet, të qetësohet dhe paqësohet në fatkeqësinë e tij.

Në episodin e III-të, Kori e sheh Dalilën të veshur për bukuri dhe të përcjellur nga vashat e reja filistine duke iu afruar Samsonit. Me të dëgjuar për ardhjen e saj, Samsoni reagon me neveri. Ajo ngurron dhe hutohet, e prekur nga pamja e mjerë e Samsonit. Pastaj, i drejtohet atij me fjalë të buta dhe pajtuese, duke pranuar fajin e bërë në të kaluarën, duke u penduar dhe duke shprehur dëshirën që ta përmirësojë gabimin e bërë; sakaq, Samsoni me rrëmbim i hedh poshtë këto orvatje, duke i konsideruar si dyftyrësi. Mirëpo, Dalila vazhdon me avazin e saj: ajo pranon se sjellja e saj ka qenë pasojë e një dobësie, prandaj ishte e udhës që t'ia falte dobësinë e saj. Veç kësaj, ajo kishte qenë e nxitur edhe nga dashuria, ngase kishte dashur ta kishte Samsonin për vete dhe nuk kishte besuar se filistinët do të silleshin ndryshe me Samsonin. Samsoni e hedh poshtë lutjen e saj. Ai nuk ia falë vetes dobësinë, përse atëherë t'ia falë asaj dobësinë? Prandaj, Samsoni mendon se kjo bisedë zbulon mëkatet, të cilët mundohen t'i fshehin. Atëherë, Dalila jep një sqarim tjetër. Ajo pranon se e kishte ndërruar mendjen ndaj Samsonit dhe e kishte lënë në baltë, për shkak të këmbënguljes së krerëve dhe priftërinjëve filistinë, të cilët ia kishin ndërruar mendjen përmes argumenteve të atdhetarisë dhe të fesë. Por, Samsoni përgjigjet se pasi që ai e kishte marrë për grua, ajo nuk kishte obligime të mëtejme ndaj popullit të saj, sepse vetëm feja e rrejshme do të pranonte që ta arrijë qëllimin përmes krimi, prandaj sipas Samsonit, perënditë e filistinëve e kanë dënuar vetveten. Për një çast, Dalila fillon të ankohet, ndërsa ankesa e saj tingëllon si sarkazëm. Më pas, ajo vendos të përdorë disa mjete tjera nxitëse, duke i ofruar Samsonit dashuri të ngrohtë dhe zotim për ta liruar nga robëria. Mirëpo, Samsonit nuk i bëjnë përshtypje këto sprova, veçanërisht kur ai tani nuk pret mirëbesim si dikur. Verbëria e tij do ta linte atë në mëshirën e saj, prandaj e parapëlqen burgimin në vend të shtëpisë së saj. Dalila bën një përpjekje të fundit, duke i ofruar dashuri intime.

Mirëpo, rreptësia e reagimit të Samsonit nuk mund ta kthejë më Samsonin, kështu që më në fund ajo e zbulon fytyrën e saj të vërtetë. Përse ta poshtëronte veten më tutje? Megjithëse, në Izrael do ta ketë namin e keq, në atdheun e saj ajo do të shpërblehet me mirënjohje dhe nderim nga bashkatdhetarët filistinë, të cilët do ta marrin si një heroinë të popullit. Si rrjedhojë, ajo do ta pranojë homazhin e bërë ndaj saj dhe do ta braktisë Samsonin me fatin e tij. Lamtumira e saj në ndarje, e zbulon karakterin e saj të vërtetë. Si të këtillë, e kupton si Samsoni ashtu edhe Kori. Por, Kori me këtë rast është i impresionuar me vendosmërinë e Samsonit përballë tundimeve të saj.

Takimi ndërmjet Samsonit dhe Dalilës është rasti më i madh dramatik në fabulën e kësaj drame. Autori e shndërron këtë rast, në një kthesë të gjendjes shpirtërore dhe mendore të protagonistit. Paraqitja e Dalilës, është bërë disa herë nga referencat e mëparshme për ndikimin e saj fatal. Ishte thelbësore që vendosmëria dhe qëndrimi refuzues i Samsonit të sprovoheshin para saj. Në këtë mënyrë, ajo i kontribuon rritjes së intensitetit dramatik në subjektin e dramës.

Atmosfera e përgjithshme në "Samson Agonistes" është e errët dhe e nderë, prandaj paraqitja e Dalilës lozonjare, skofiare dhe elegante arrinë një efekt të kundërt. Veç kësaj, dinakëria e saj e

rrysur, ndonëse mjaft e urryer, është në kundërshtim me qëndrimet e çiltërta të shumicës së personazheve. Roli i saj në situatat dhe konfliktet e dramës është më i vogël se roli i Samsonit, por mjaft i rëndësishëm për përshpejtimin e ngjarjeve. Ajo mishëron një femër, e cila jeton nga epshi, por e cila është po ashtu mjaft e ligë dhe djallëzore. Efekti i kësaj skene në Samsonin është vendimtar. Ndërsa, ndërhyrja e Manoas në favor të lirimit të Samsonit me shpërblësë nuk ndikon në Samsonin. Tundimet dhe provokimet e Dalilës, të cilat Samsoni i refuzon, duke parapëlqyer gjendjen e tij të rënë, tek e fundit e zgjojnë atë nga letargjia. Fuqia morale me të cilën ai i rezistoi asaj është e njëjta fuqi, e cila ndikoi në të që të vuante pasojat e ndëshkimit. Kësaj radhe, si duket nga një vendim negativ, doli një energji pozitive, sepse tani fillon rimëkëmbja dhe ripërtirja morale e Samsonit. Me një fjalë, pendesa dhe pranimi i dënimit nuk janë vendime negative, por pozitive, ngase nga jashtë ato mund të duken pasive, por në shpirt ringjallin fuqi aktive.

## 1.6. Episodi i katërt

Kori moralizon për natyrën e pashpjegueshme të dashurisë së femrave. Sikur dashuria e femrës të fitohej dhe të ruhej në saje të epërsisë fizike ose virtytit etik dhe moral, të dy gratë e Samsonit nuk do të vepronin me Samsonin ashtu si kishin vepruar. A mund të sqarohet kjo me shpjegimin se femra, nga një anë është e pajisur nga jashtë me bukuri, ndërsa nga ana tjetër, brenda në shpirt dhe në kuptimin moral ajo duhet të ketë mbetur e mangët? Ose a është natyra e femrës aq egoiste sa që të mos jetë në gjendje të gëzojë një dashuri të vërtetë apo së paku një besnikëri? Çfarëdo qofshin shpjegimet, femrat i shkatërrojnë dhe i dërrmojnë shpresat e meshkujve. Pas martesës, shumë burra të mençur dhe të mirë zbulojnë se gruaja, të cilën e kanë zgjedhur, bëhet pengesë dhe jo një shok që të ndihmon. Gruaja e mirë, e cila nxit burrin e saj në rrugën e tij të virtytit, është e rrallë. Megjithatë, Perëndia më shumë e respekton virtytin, i cili është fituar me përlëshje përkundër vështirësive. Duhet përfunduar se Zoti me të drejtë ua ka dhënë burrave pushtetin mbi gratë, dhe se Zoti mendon se ata atë pushtet duhet ta përdorin, sepse sundimi i grave është katastrofik.

Kori dikton ardhjen e Harafës, të një filistini vigan, ngatërrestar, kapadai dhe belaxhi. Harafa shpall se ai ka ardhur për të parë me sytë e tij prijësin e lavdishëm të Izraelit, për ta matur fuqinë me atë të Samsonit. Ai pranon se i vjen keq, që nuk janë takuar ato ditë kur Samsoni ishte i njohur si trim, sepse ai me siguri do ta mposhtëte Samsonin. Samsoni ia kthen se Harafa ka bërë mirë që s'është takuar me te, ngase po të kishin pasur një dyluftim në një vend të caktuar, Samsoni i armatosur vetëm me një shkop, do ta plandoste për dhe Harafën e armatosur deri në dhëmbë. Harafa ia kthen se vetëm magjia mund t'ia sigurojë Samsonit fitoren. Por, Samsoni deklaroi se ai s'ka nevojë për kurrfarë magjie, sepse e ka fuqinë e vet të dhuruar nga Zoti, e nëse Harafa ngul këmbë, atëherë le të paraqitet si mbrojtës i Dagonit, Zotit të filistinasve dhe le t'i dalë në mejdan Samsonit, mbrojtësit të Izraelit. Kësaj radhe, Perëndia do ta pranojë si mbrojtës edhe njëherë Samsonin, pas pendesës së Samsonit. Harafa i shmanget sfidës, duke e quajtur Samsonin kriminel. Samsoni i hedh poshtë akuzat e tij dhe i bën sfidë përsëri. Mirëpo, tanimë është e qartë se Harafa nuk guxonte ta pranonte duelin, ndonëse çierrej dhe kërcënonte panda. Ai ikën me qëllim që të ankohej tek prijësit filistinë, për shkak të paturpësisë së Samsonit. Mirëpo, Samsoni u ringjall shpirtërisht dhe u trimërua nga ky takim, prandaj edhe do të marrë parasysh çdo rrezik që do t'i kanoset. Në mundimet dhe torturat e mëtejme nga armiqë e tij, ata mund t'ia sjellin lirinë përmes vdekjes. Mirëpo, ai mbase ende mund t'i shkaktojë ndonjë katastrofë shtypësve të tij.

Beteja e fjalëve nuk është vetëm një interludë, por është një lloj çlodhjeje, tensioni emocional dhe moral pas skenës me Dalilën. Ka një lloj ironie në kapardisjen dhe mburrjen me

fjalë të kota të belaxhiut filistin, të cilin Samsoni e godet dhe fyen me guxim të madh. Por, efekti i vërtetë dramatik i kësaj skene është ndryshimi shpirtëror i Samsonit. Tani e ka të qartë, se ai është dhe do të mbetet gjithnjë shërbëtori, misionari dhe mbrojtësi i Zotit. Atij i shkon nga mendja edhe hakmarrja ndaj armiqëve, por fakti më i rëndësishëm është se atij tani i është përtrirë vullneti dhe dëshira për aksion.

### **1.7. Episodi i pestë**

Edhe Kori u trimërua dhe u ringjall pas vizitës së Harafës. Kori entuziazmohet nga veprimi heroik, i shkëlqyer dhe i patrembur kundër armiqëve të Zotit dhe të lirisë. Durimi dhe qëndrueshmëria heroike në vuajtje është po ashtu një lloj pastrimi nga mëkatet dhe sigurimi i shëlbimit. Samsoni ende ka fuqi të bëjë vepra madhore, por për shkak të verbërisë së tij, Kori është i prirur të parashikojë vetëm një fitore shpirtërore në durim.

Kori vë re Lajmëtarin e mbretit filistin dhe paralajmëron brenga, ngatërresa dhe telashe të tjera për Samsonin. Lajmëtari e përcjellë porosinë: Samsoni urdhërohet që të paraqitet para prijësve dhe popullit filistin, të mbledhur në kremtimin e Dagonit dhe t'i dëfrojë të pranishmit me aktet e fuqisë së tij. Samsoni në fillim e refuzon ftesën prerazi, ngase feja e tij i ndalonte që të marrë pjesë në ritet dhe zakonet pagane. Nga ana tjetër, ai nuk donte ta poshtërojë veten, duke e përdorur fuqinë e tij për t'i dëfryer shtypësit. I dërguari i mbretit e paralajmëron se refuzimi i Samsonit do të ndëshkohet, pastaj kthehet tek ata që e kishin dërguar.

Kur mbetet vetëm me Korin, Samsoni e arsyeton refuzimin e tij. Ai beson se Zoti do të fyhej sikur Samsoni të pranonte urdhërin, ndonëse nuk ka dyshim se Zoti do të bënte një përjashtim të veçantë të detyrimit për ndonjë qëllim të lartë. Duke i thënë këto me neveri, Samsonit i shkrep një ide e re, sepse ai menjëherë e ndërron mendjen, duke e vënë në dijeni Korin, se ai në të vërtetë do ta zbatojë urdhërin e filistinëve, por jo duke e përdhosur e cenuar fenë e tij. Kur kthehet i Dërguari i mbretit filistin me kërcënime të mëdhaja, Samsoni shtiret se do ta pranojë urdhëresën dhe do të niset me të. Duke i thënë lamtumirë Korit, ai i bind pjestarët e Korit se s'do të bëjë asgjë që do të çnderonte atë. Kori e bekon Samsonin, duke evokuar shfaqjen e shpirtit të shenjtë nga ana e Samsonit.

Me mesazhin e marrë nga krerët filistinë, rrjedha e ngjarjeve arrin në fazën e fundit. Tani ritmi përshpejtohet, meqë edhe vendimet merren me nxitim dhe pasojat janë të pashmangshme. Gjendja shpirtërore e protagonistit ka pësuar një evolucion, kështu që tani ai s'ka peripeci dhe është i gatshëm që të ndër marrë çdo lloj aksioni të drejtë. Kjo vepër e kompletuar dramatike, është edhe një simbol poetik në gjendje që të jetësojë porosinë e fundit të Miltonit.

Skena e vendimit të Samsonit dhe nisja e tij është mjaft dramatike dhe e nderë për shkak të përdorimit të implikimeve teologjike nga Miltoni. Me këtë rast, Samsoni i përmend pengesat fetare, me të cilat ballafaqohet ai. Miltoni, vëren se Samsoni e mori vendimin me cytjen e Zotit. Vetëm nxitja nga Zoti e bën Samsonin që të ndër marrë aksionin vetëshkatërrues në fund. Edhe Kori me këtë rast thekson se Samsoni, në aktin final dhe vendimtar, kishte qenë i frymëzuar nga Zoti dhe e kishte përmbushur porosinë e tij.

### **1.8. Përmbyllja**

Me rikthimin e Manoas fillon ekzodi i dramës që përmbillet me paraqitjen ose ardhjen e kasnecit, i cili sjell lajme për vdekjen e Samsonit. Në këtë pjesë të dramës, Manoa e njofton Korin se pas bisedave me disa krerë filistinë, kishte shpresë për lirimin me shpërblesë të Samsonit. Kjo bisedë e patrazuar, e qetë dhe shpresëdhënëse me Korin, ndërpritet papritmas nga

një thirrje që tregonte se si filistinët po e prisnin Samsonin, ndërsa pas një çasti, u dëgjua një britmë e tmerrshme, e cila i tmerroi si Manoan ashtu edhe Korin, por megjithatë dha një fije shprese, se një hata e madhe i kishte pllakosur armiqtë e izraelitëve. Pas një copë here arrin një kasnec izraelit, i cili u rrëfen në hollësi se ç'kishte ndodhur si dhe cilat kishin qenë fjalët e fundit të Samsonit. Metodat e skenës së fundit janë të dramës antike greke, sepse janë shumë efikase në skenë. Veç kësaj, ironia dramatike e rrit intensitetin e bisedës së Manoas me Korin. Komentet dhe shkoqitjet e Korit klasik në këtë dramë janë të mprehta, domethënëse dhe aforistike.

Komentet e Korit dhe të Manoas formojnë komentin që e përmyll dramën. Në këtë pjesë të fundit të dramës, Kori këndon për vdekjen triumfuese të Samsonit dhe kremtimin e disfatës së adhuresve të Dagonit nga Perëndia e vërtetë e Izraelit si dhe përtrirjen dhe ringjalljen e lavdishme të Samsonit. Manoa merr pjesë në shprehjen e ndjenjave si të pikëllimit ashtu edhe të homazhit dhe të lavdimin në fjalimin e tij të fundit, në të cilin mburret me vdekjen e lavdishme të birit. Ai është i privilegjuar dhe i nderuar, që bashkë me fisin e tij do të ketë rast të bëjë homazhe mbi trupin e Samsonit dhe parashikon lindjen e kultit kombëtar nga varri i Samsonit. Kori e përmyll misionin e vet, duke i kënduar një himn dhe duke i thurur lavdi Provanisë Hyjnore të Zotit<sup>5</sup>. Akti fisnik i Samsonit e kishte përlijur dhe justifikuar fuqinë dhe drejtësinë e Zotit kundër dyshimit, dilemës dhe të ligës. Besimtarët mbeten të kënaqur, kurse emocionet e tyre platiten apo shuhen nga madhështia tragjike e ngjarjes që ndodh para tyre.

## **2. Analiza e personazheve**

Kthimi i Samsonit në rrugën e Zotit, shërimi i tij nga humbja e lavdisë dhe fuqisë përvijohet në këtë vepër jo në përputhje me veprimet e protagonistit, po më parë në pajtim me ringjalljen dhe vetëdijësimin e tij shpirtëror.

Pothuajse pa ndonjë përjashtim, komentuesit tani së voni e kanë lexuar Samson Agonistin si një studim të ringjalljes<sup>6</sup>. Një numër i konsiderueshëm i tyre ka shfaqur mendimin se mënyra e shpalimit të ideve të Miltonit, në veprën e tij në latinishte “Doktrina e Krishterë”, paraqet një koment të rëndësishëm të mjeshtërisë poetike të zhvillimit shpirtëror të Samsonit. Këto kritika kanë vënë në dukje se heroi i veprës, shpeshherë mbështetet në monologun hyrës, se ai me vullnetin e tij e shfaq dëshirën e tij dhe se procesi i ringjalljes së tij shpirtërore është bërë shëmbëllyeshëm me “Doktrinën e ringjalljes” dhe të këndelljes së Miltonit. Ai ankohet për verbërinë dhe robërinë në të cilën ndodhet, vuan nga ndjenja e një ankthi shpirtëror, mirëpo para se të bëjë ndonjë hap drejt këndelljes, pikë së pari i duhet të kuptojë mëkatit e pastaj, edhe të ballafaqohet me të. Ai në esencë vepron kështu duke kaluar nëpër procesin e konvertimit apo kalimit të shpirtit të tij, prej të keqës në të mirën dhe në ripërtrirjen shpirtërore.

Sipas pikëpamjes së Miltonit, ringjallja është e pamundur pa ndihmën e Zotit, sepse njeriu i cili ka rënë në mëkat, nuk mund të meritojë ndihmën dhe drejtësinë e Zotit menjëherë. Po kështu, individit mëkatar, duhet të ketë gatishmërinë që të meritojë mëshirën dhe të gjejë mundësinë për këndelljen shpirtërore. Mirëpo, është e qartë se ky proces zhvillohet deri në fund, ngaqë Samsoni kalon nëpër faza të pandërprera të pendesës d.m.th të pranimit të mëkatit, të pendesës, të rrëfimit,

---

<sup>5</sup> Prince, F.T., vep. e cituar fq. 95-117

<sup>6</sup> Tillyard, E.M.W.: Milton, Pinguin Books, London, 1966, fq. 302-311; Wilson, A.N., The Life of John Milton, Pimplico, London, 2002, fq. 238-9; Shi edhe Prince, F.T., vep. e cituar, fq. 132. Daichies, D., Milton, Hutchinson University Library, London, 1964, fq. 230-248. Lidhur me këtë shih edhe studime të tjera, Hawkins, Sh. H., Samson's Catharsis. In Milton Studies II). Ed. James D. Simmonds. Pittsburgh, University of Pittsburg Press, 1970, Kolbrenon, W., Milton's Warring Angles: A Study of Critical Engagemets, Cambridge, 1997, etj.



të shmangies nga e liga dhe kalimit në rrugën e drejtë. Duhet të kihet parasysh se shpeshherë në dramën “Samson Agonistes” theksohet statusi i veçantë i protagonistit, si të një personazhi, i cili është dërguar në një mision hyjnor. Në monologun e tij hyrës, Samsoni deklaroi se edukata e tij: “Ishte urdhëruar dhe paracaktuar, si edukatë e një personi të veçuar e të zgjedhur nga Zoti, i cili ishte paracaktuar për të bërë vepra madhore”. Tema e përzgjedhjes së veçantë, vërehet edhe në fjalimet e Manoas dhe të Korit dhe shpeshherë me bindshmëri artikulohej edhe nga vetë Samsoni: “Unë nuk jam një individ i rëndomtë, por kam mjaft fuqi dhe urdhër nga Hyjnia për të çliruar vendin tim”.

Ndërkaq, kur hasim në te për herë të parë në burgun e Gazës, dijmë se është treguar i pabesë ndaj besimit hyjnor. I nxitur nga interesi vetiak, duke rënë në fajin e hamendjes e të vetëbesimit, me kokëfortësi e braktis misionin e tij dhe në këtë mënyrë, e humb edhe burimin e fuqisë së tij. Para se të fitojë përsëri rolin e “mbrojtësit besnik” të Zotit dhe të vëjë në jetë rolin e tij të përcaktuar, si çlirues i Izraelit, ai duhet të mësojë se cilat janë limitet e fuqisë së tij. Veç kësaj, ai duhet të mësojë, që të heqë dorë nga sfidat egoiste, në mënyrë që të shërbejë besnikërisht si mjet i Zotit, jo duke u kapardisur si mburravec, po duke bashkëpunuar me mëshirën e hirësinë dhe duke i kryer aktet e misionit në kohën e caktuar nga vetë Zoti.

Është e udhës të thuhet se në strukturën poetike të dramës “Samson Agonistes”, temat e ringjalljes, rimëkëmbjes dhe përzgjedhjes së misionit të veçantë, janë thurur dhe zhvilluar me mjeshtëri që në fillim të dramës. Heroi na paraqitet si mëkatar në dy kuptime: ai është më parë si trashëgues i mëkatit, nga një anë të Adamit, dhe si përfaqësues mëkatar i përzënë nga shërbimi hyjnor, nga ana tjetër. Të dy këto gjendje tejkalohen me zhvillimin e ngjarjeve në dramë, si dhe me rritjen shpirtërore, me fisnikërimin e Samsonit, me ndërgjegjësimin e tij gjithnjë e më të thellë, veçanërisht përballë sprovave dhe tundimeve të bëra nga Manoa, Dalila, Harafa dhe Lajmëtari filistin. Konflikte të ndryshme, e nxisin atë që të tregojë besim dhe pendesë. Kështu, me zhvillimin e procesit të këndelljes, imazhi hyjnor që është shfrytëzuar në Kopshtin e Parajsës, i kthehet përsëri. Lidhur me këtë ka mundësi që kjo metarmozë shpirtërore është rritja shpirtërore dhe edukative e tij, e cila e transformon atë nga një përfaqësues me motive vetiake, (i cili vepron sipas mendjes së tij), në një mjet të caktuar, që i përgjigjet vetëm impulsit intim të “veprave frymëzuese”, përmes të cilave Zoti e vë atë në shërbimin aktiv<sup>7</sup>.

Në aktin e parë të dramës, domethënia e gjendjes së rënies së protagonistit shqyrtohet nëpërmes një retrospektive ose të kundërvënies të së kaluarës ndaj të tanishmes, ndërmjet misionit të parashikuar të Samsonit si të mbrojtësit të Zotit, të çliruesit të Izraelit e të gjendjes së tij aktuale si skllav filistin i lidhur në pranga, të cilin Zoti si duket, si ta kishte braktisur. Kur e marrin Samsonin nga burgun, ai ankohet se ndërsa ndërprerja e vuajtjeve, falë celebrimit të Dagonit, mund t'ia lehtësojë pak dhimbjet e trupit, ky çast nuk e lehtësonte gjendjen e rëndë shpirtërore të tij, e cila sulmohet nga “mendime të atilla shqetësuese, të cilat i sulen atij si një luzmë grejzash të xhindosura”: Dhe koha e tashme kaloi,/ Ai që isha dhe ai që jam tash/ O, përse lindja u parashikua/ Dy herë nga një engjëll, /Si të isha ndonjë njeri i shënuar nga Zoti,/ I paracaktuar për vepra madhështore/ A duhet të vdes/ I tradhëtuar, i robëruar dhe i verbuar,/ I përbuzur dhe i përçmuar nga armiqtë;/ Për t'u torturuar në pranga në misionin/ Me fuqi të dhuruar nga Zoti!/ Fjala ishte dhënë se unë/ Izraelin do ta çliroja nga zgjedha filistine!/ Kërkoni tani çlirimtarin e madh, e do ta gjeni/ Të verbër në Gazë në punë me skllëverit...

Në këtë situatë dramatike Samsoni mund të krahasohet me një Herkules ose Prote. Ai ka një imazh tragjik sepse është i privuar nga fuqia dhe heroizmi. Përkundër vetë mëshirës fisnike, të cilën e shfaq përballë kundërshtimit, ai ndodhet në një situatë që karakterizohet nga humbja e

<sup>7</sup> Tillyard, E.M.W., vep. e cituar, fq. 304; Prince, F.T., fq. 120-135

mëshirës hyjnore dhe drejtësisë së brendshme. Në këtë gjendje Samsoni, si Adami dhe Eva, të cilët posa kishin mëkatuar në librin e nëntë të “Parajsës së humbur”, është i paaftë për mendime dhe vepra vetiake, kurse humbja e besimit, dëshmohet edhe nga dyshimet dhe ankesat e tij. Mirëpo, rimëkëmbja e Samsonit zë fill, kur ngritet perdja: Zgjate pak dorën prijëse për të ecur përpara/ Në këto shkallë të errëta, të ecim përpara.../ Lermëni të marr frymë,/ Në ditën pranverore.

“Dora prijëse”, e cila udhëheq atë është dora e Zotit si edhe ajo e një figure me qëllim të papërmendur, e cila e shpie atë nëpër shkallët e errëta e deri në ledhë, ndërsa fryma e ëmbël e qiellit “në ditën pranverore”, është simbol i veprimtarisë së fshehur të mundësisë për ringjallje. Krugëdalja është e mundshme që nga fillimi: shkallët tani të errëta, përmes të cilave del nga burgu, paraqesin fazat e ringjalljes dhe të ripërtritjes së tij.

Në saje të kthimit të arsyes, ai e bën hapin e parë në rrugën e shërimit, pothuajse në të njëjtën kohë, duke pranuar qartaqejfas, se ai vetë mund të ketë pasur përgjegjësi individuale për gjendjen e rëndë në të cilën ishte kantandisur: Por prit, më mirë mos të nxitojë e të dyshojë/ Në profetizimin hyjnor, po vallë çdo të ndodhë/ Nëse çdo gjë e parashikuar, s’u jetësua dot/ Pikërisht me fajin tim?/ Nga kush të ankojem, pos nga vetëvetja.

Vetëdija e Samsonit për fajësi dhe pranimi i mëkatit, është pikënisja për kthimin e tij të dalëngadalshëm te Zoti, meqë pranimi i mëkatit është njëri ndër hapat e parë të pendesës, ashtu si thekson Miltoni në veprën e tij “Doktrina e Krishterë”.

Ndërkaq, brejtja e ndërgjegjes nuk është pendesë, kështu edhe hapi i parë i Samsonit në shtegun e shëlbimit ose të shpëtimit të shpirtit është i pasigurt dhe i ngurrar: O, pafuqi e mendjes, në trupin e fortë!/ Po ç’është forca pa praninë e fuqishme/ Të mençurisë, pos një barrë e rëndë,/ Krenare, e prirur për dështime/ Nga huqet e dobëta, që s’duhet të sundojnë më;/ Por t’i shërbejnë urdhërit të mençurisë.

Në këtë fazë të hershme të vetëdijësimit të vagulluar të vdekjes shpirtërore, autori është në gjendje të krijojë tek protagonistin efekte diametralisht të kundërta. Nëse ndjenja e fajësisë së Samsonit është hapi i parë për mundësinë e shërimit të tij, atëherë nga ana tjetër, ndjenja e tij e tëhuajsimin nga mirësia hyjnore, e nxitur nga dyshimet në misionin e shpëtimtarit të Izraelit, e shpjen atë buzë greminës së dëshprimit. Ajo që është edhe më e keqe, ai pothuajse tërësisht e eliminon shansin për rikthim në misionin e tij të paracaktuar. Samsonin nuk e ka detyruar fati i pamëshirshëm në një cak të parashikuar; “fati i tij” gjendet në përdorimin e arsyes dhe të vullnetit të lirë të tij kur ai ftohet për të pranuar mëshirën ringjallëse. Është po ashtu me rëndësi të theksohet se Miltoni e zhvillon temën e këndelljes shpirtërore të Samsonit në përputhje me vetëdijësimin e mëtejshëm të tij për misionin e veçantë që kishte. Në fillim, Samsonit i duket se ka dështuar pas mëkatit në rolin e tij si çlirimtar, e ky ndërgjegjësim e shpie atë, (ndërsa bisedon me Korin për dy martesat e tij), në njohjen më të thellë të shkaqeve të humbjes së mëshirës së Zotit dhe e çon atë në një hap më tutje drejtë pendesës: Në luginën e Sorekut u njofta me Dalilën,/Atë kulçedër të poshtë, e cila më zuri në kurth;/Por, ajo s’ ishte shkaku kryesor,/ Që u mashtrova me fjalë të rrejshme;/ (O, dobësi!)/Ia besova kështjellën e heshtjes një femre.

Martesa me Dalilën, përmes së cilës ai po përpiqej të vazhdonte përleshjet dhe sulmet kundër filistinëve në misionin e tij të premtuar, nuk ishte “nxitur” nga Zoti: ky ishte një aksion i ndërmarrë nga vetë Samsoni. Ky ishte më parë një arsyetim sesa një argument, kështu që Samsoni gaboi. Duke u martuar me gruan nga Timnahu, ai i ishte kundërvënë ligjit dhe e kishte shkelur kanunin e Ligjdhënësit, meqë shërbyesit e Zotit duhej t’u përmbaheshin urdhërave hyjnore. Duke u martuar me Dalilën, ai e bëri mëkatin e mendjemadhësisë së tepruar. Në të vërtetë, ai vetëm duhej t’i priste urdhërat e Zotit dhe t’i zbatonte ato. Mirëpo, mania e tij për aksion, e çyt atë që të marrë guximin dhe ta humbasë mëshirën. Por, hamendja dhe guximi i

tepërt, janë të lidhura edhe me një numër mëkatesh të tjera sikurse që janë: humbja e modestisë dhe bërja e mëkatit mortor të krenarisë së tepruar. Merita për fitore të famshme kundër barbarëve i takonte Zotit. Samsonit kishte filluar t`i rritej mendja e krenaria individuale. Prandaj, ai besonte se kishte merita për të gjitha këto të bëma ngadhnjimtare. Duke e harruar burimin e tij të vërtetë të fuqisë Zotin, ai ishte kapardisur dhe ishte bërë: Si ndonjë Zot i vogël,/ I admiruar dhe i dashur nga të gjithë/ Në truallin armiqësor ku askush/ S`më del dot në mejdan.

Me rritjen e mburrjes dhe të vetënderimit, përunjësia e tij përball Zotit u zhduk. Prandaj, para se të bëhej një dorë e vullnetit hyjnor, Samsoni duhej edukuar<sup>8</sup>. Së pari, sipas doktrinës fetare duhet të përvetësojë virtytin e përunjësisë dhe në vend të vetëkënaqësisë arrogante, duhej të tregonte keqardhje e nënshtrim absolut para Zotit; së dyti, ai duhej ta mësonte mësimin e durimit; së treti, ai lypsej të mësonte ligjin e besimit, kështu që përkundër mëkateve të tij dhe situatës së rëndë, ai duhet të ketë besim në mëshirën hyjnore dhe në misionin e tij të paracaktuar e të veçantë. Përunjësia, durimi dhe besimi me sa duket janë kundërhelme ndaj tre mëkatëve: krenarisë së tepërt, ose mendjemadhësisë, guximit të tepërt dhe dyshimit. Kështu, përmes vuajtjes, përimitimit dhe një sërë “sprovash të mira”, të dërguara nga Zoti, Samsoni do të kalojë nëpërmjet fazës së larjes së mëkatëve, e pastaj do të hyjë në fazën e vënies në jetë të misionit të tij hyjnor për çlirimin e Izraelit.

Në aktin e dytë të dramës, Samsoni ballafaqohet me Manoan, i cili sikurse Kori, ankohet nga ndërrimi i fatit të të birit. Dhe, ashtu sikurse që kishte bërë Samsoni më parë, tani edhe Manoa e ve në dyshim “drejtësinë hyjnore”, e cila e ngriti birin e tij në një lavdi aq të madhe më parë, e pastaj me të bërë Samsoni vetëm një gabim, e la në baltë: A thua për këtë engjulli zbriti dy herë nga qielli?/ Për këtë të pajisi me shenjë të tjerë, si ndonjë lule?/ Të zgjedhi, të bëri me famë për ca kohë,/ Të bëri të mrekullueshëm, e pastaj në një çast,/ Ti u zure në kurth, u mposhte, të lidhën./ U bërë gazi i armiqëve, rob, i mjerë, i varfër,/ I kllasur në burg, për të punuar me robërit./ Unë mendoj se atë që Zoti e zgjedh,/ Për veprat madhështore, nëse si rob gabon,/ Atë s`duhet katandisur në këtë gjendje.

Megjithëse Samsoni e qorton t`atin për padinë e madhe që ai ia bën profetizimit hyjnor, është më se e qartë se edhe Samsoni është i prekur dhe i shqetësuar nga këto fjalë. Ç`është e vërteta, Manoa e ka prekur plagën e Samsonit, sepse le të na kujtohet se këto janë pikërisht ato pyejtje, të cilat Samsoni i kishte bërë vetës në monologun e tij hyrës, duke iu ankuar nga mungesa e barazisë ndërmjet profetizimit dhe fatit në misionin e tij si përfaqësues i zgjedhur hyjnor.

Më parë, ai e kishte mposhtur krenarinë dhe vetëbesimin e tepërt, duke kuptuar se martesja e tij me Dalilën, kishte qenë një akt i mendjemadhësisë. Mirëpo, tani këtu, kur Manoa e vë në dyshim drejtësinë e Zotit, Samsoni zhytet në një lloj zhgënjimi tjetër. Por, pikërisht kjo gjendje shpirtërore e nxitë atë të bëjë një akt tjetër, ai beson se Zoti ka hequr dorë nga ai dhe prandaj atij i kanë humbur të gjitha shpresat. Ai e ka përshtypjen se tani nuk ka mundësi për të vënë në jetë misionin e fatit të tij. Ai kishte vepruar si një i llastuar i Zotit, duke e vënë në jetë drejtësinë në emër të Zotit, por pa pëlqimin dhe miratimin e tij. Tani i ballafaqohet me dyshimet e t`et, që identifikohen me dyshimet e tij, ai ka arritur në çastin kur bëhet një kthesë në rritjen e tij shpirtërore. Pikërisht në këtë kthesë, paraqitet edhe sprova e parë. Manoa, i cili ironikisht po përpiquej ta lironte me shpërblese të birin, e këshillon: Pendohu dhe pranoje fajin e bërë./ Por mos vepro kundër vetëvetës, biro,/ Pendohu për mëkatin e bërë,/ Ndoshta Zoti ta falë fajin,/ Mos refuzo atë që të ofrohet, kush e di/ Ndoshta Zoti të ka dërguar ty/ Tek ne, që të të kthejë./ Në shtëpinë tënde të shenjtë,/ Në atdhe,/ Ku do të mund të blatosh dhurata,/ E ta largosh mllëfin e tij/ Me lutje dhe përbesime të reja.

<sup>8</sup> Daichies, D., vep. e cituar, fq. 241-2

Manoa pra, këshillon lirinë, rehatinë, paqën dhe tërheqjen nga shërbimi aktiv si dhe fajshlyerjen “me anë të lutjeve dhe përbetimeve të reja”. Në rrafshin njerëzor, kjo këshillë dhënë një njeriu, i cili ka vuajtur shumë, duket mjaft e arsyeshme. Mirëpo, meqë ndëshkimi shpeshherë është “shkaku i pendesës”, Samsoni nuk duhet të bëjë përpjekje për t’u shmangur nga ndëshkimi. Misioni i Samsonit ka marrë fund dhe Zoti nuk ka nevojë për të, së këndejmi edhe këshilla e tij është në këtë frymë<sup>9</sup>.

Samsoni pranon se i Ati i tij ndoshta ka të drejtë dhe se ditët e tij kur ai shërbente si shpata e Zotit kundër filistinëve pothuajse kishte marrë fund: Tani i verbuar, i shkurajuar,/ I turpëruar dhe i mposhtur,/ Me se mund të jem i dobishëm/ Kur s’kam si t’i shërbej,/ Popullit tim, urdhërit hyjnor...

Duke marrë parasysh mungesën e fuqisë fizike, morale dhe shpirtërore të Samsonit nga një anë, dhe të indiferencës së Zotit ndaj tij, nga ana tjetër, fitohet përshtypja se Samsoni do të bie patjetër nën ndikimin e tundimit të Manoas. Por, ai e hedh poshtë këtë sprovë. Kujtimi i madhështisë së dikurshme, nuk e le që të bëhet “gazi” i mysafirëve kureshtarë. Së këndejmi, ai e flak sfidën e Manoas.

Tundimi i Manoas ka për pasojë vetëm ballafaqimin e Samsonit me gjendjen e tij të vërtetë shpirtërore. Në këtë mënyrë, qëllimi i mirë, i mbështetur në përvojë të Manoas e të Samsonit, që të kridhet edhe më tepër në dëshpërim: Vrapimi im për famë, mbaroi,/ Me vrapin e turpit,/ E unë së shpejti do të jem,/ Me ata që prehen.

I cytur nga dashuria ndaj të birit, Manoa nxiton për t’i siguruar mjetet për lirinë me shpërblese, duke e lënë Samsonin në duart e Atit tjetër, Zotit të Madh, i cili megjithëse me mjete shumë madhore, interesohet për ta çliruar Samsonin nga burgu dhe varri.

Në aktin e tretë të dramës Samsoni ballafaqohet me Dalilën, e cila ia beh “si ndonjë anije madhështore”: Ajo ia beh e stolisur si një velore,/ Me vela të fryra/ E lajkatur nga të gjitha erërat/ Që e lëkundin.

Imazhet poetike të lënë të kuptosh se konfrontimi do të ketë karakterin e një beteje detare. Mirëpo, ndeshja do të zhvillohet me retorikë, jo me topa. Vetë arritja e Dalilës, grackës së tij “të përsosur” i mjafton Samsonit, që ai të dalë nga gjendja e dëshprimit në të cilën e kishte hedhur vizita e Manoas: “Gruaja ime”, bret ai: “Tradhtarja ime, hiçmu sysh”. Megjithëse, paraqitet si e penduar, Dalila është ende një sfidë dhe ngasëse e rrezikshme<sup>10</sup>.

Ndonëse, përgjigja e tij në fillim është e provokuar nga krenaria e lënduar si dhe kujtimi i hidhur i vuatjeve, këndellja e frymës luftarake të Samsonit e bën atë psikikisht të aftë për t’i bërë ballë sfidës. Përgënjeshtrimi dhe kundërshtimi i fjalëve dhe argumenteve të saja me këmbëngulje, e detyrojnë atë që ta përdorë arsyen e shëndoshë. Do thënë se, ai me këtë rast nuk e hedh poshtë sfidën e saj ashtu sikurse që pat hedhur atë të Manoas. Ai e përmban veten, dhe në këtë mënyrë arrin një shkallë të vetëdijes më të lartë. Me një pendesë të shtirur dhe “ende duke patur frikë nga pakënaqësia e Samsonit”, Dalila paraqitet si e penduar duke thënë se ajo për hir të jetës dhe dashurisë bashkëshortore, kishte ardhur vetëm të kërkojë falje nga Samsoni për fajin e bërë në nxitim.

Nga ana e tij, Samsoni duke parandier “nxitimin” e gabimit, e kupton menjëherë qëllimin e saj. Prandaj, ai e padit atë për brejtje të rrejshme të ndërgjegjës dhe për qëllimin e saj për ta thyer besimin e tij dhe për ta shpënë përsëri në një gabim dhe mëkat tjetër. Pasi dështon në orvajtjen e saj, Dalila përpiket ta ndërrojë taktikën. Ajo pranon gabimin e saj për zbulimin e fshehtësisë së fuqisë së Samsonit, por pohon se vetëm dobësia dhe frika për ta mos humbur atë në

<sup>9</sup> Po aty

<sup>10</sup> Tillyard, E.M.W., vep. e cituar, fq. 302-310

fushë të betejës ose në përqaftim të një gruaje tjetër, e kishte cytur të marrë atë vendim fatal, pa parashikuar konsekuencat. Samsonin nuk e mashtrjnë as lotët dhe as fjalët e saj të zgjedhura: “Çdo dinakëri është dobësi, në daç lute Zotin apo robin, fajin s’ta shlyejnë!”. Duke hasur përsëri në kundërshtimin e Samsonit, Dalila e përdor motivin e saj të tretë. Ajo shton se detyra shoqërore dhe feja, e kishin detyruar të vepronte në atë mënyrë. Mirëpo, as kësaj radhe Samsoni nuk u mashtrua<sup>11</sup>. Në përpjekjen e saj finale, Dalila e lut Samsonin t’i lejojë që ajo të ndërhyjë tek fisnikët filistinë për lirimin e të dashurit të saj: Në mënyrë që të shpëtojë,/ Nga ajo shtëpi – burg i urryer,/ Që të jetosh me mua/ Ku kujdesi dhe dashuria ime,/ Me zell e kënaqësi do të dëshmojë,/ Edhe do të të shoqërojë deri në pleqëri,/ Në çdo gëzim dhe hare dhe do të gëzosh,/ Edhe më shumë atë që e humbe nga unë.

Sprova dhe sfida në këtë rast është rehatia dhe çlodhja fizike, ndonëse Dalila këtyre premtimeve ia shton edhe kënaqësinë e epsheve. Kësaj radhe, Samsoni është gati dhe ka vetëbesim që t’i shporret kësaj sprove pa pikë vështirësie: Bota jote e bukur dhe lajkat,/ Nuk kanë më fuqi mbi mua,/ Fuqia e tyre është zhdukur,/ Nga dhelpëria e nepërkës,/ Unë mësova për ta mbrojtur vehten,/ Nga magjitë e tua.

Kur ajo e ka të qartë se Samsoni nuk do të bie në grackë përsëri, atëherë zbulon veten dhe reagon me mllef: Si gjarpër, që kafshon e zbulohet,/ Megjithëse rrinte i fshehur.

Takimi me Dalilën nuk ia mëson Samsonit përunjësinë, durimin ose besimin, por ky takim rezulton me zgjimin e tij nga apatia, zhgënjimi dhe dëshprimi në të cilin e kishte hedhur vizita e Manoas. Gjëja më me rëndësi në këtë episod është se ai flak kërkesat, dëshirat, lajkat, sugjerimet dhe propozimet e saja të veçanta, falë arsyes së shëndoshë dhe të drejtë, duke i tejkaluar kërkesat dhe përpjekjet e saj për ta zënë atë përsëri në kurthën, si thotë Samsoni: “Ku kisha rënë dikur”.

Në këtë fazë reagimi i tij ndaj sfidës ka një motiv vetiak, meqë qe lënduar sedra dhe krenaria e tij, mirëpo, ai do të mësojë se si të arrihet lartësia shpirtërore nëpërmjet shërbimit vetëmohues në takimet me Harafën dhe Lajmëtarin mbretëror për të cilët ngasja e Dalilës do t’i shërbejë si një prelud i nevojshëm.

Diku në aktin e katërt Samsoni konfrontohet me dy mjete të fuqisë: Harafën ose Viganin nga Gathi dhe Lajmëtarin e Mbretit filistin. Përleshjet e Harafës dhe urdhërat e Lajmëtarit, në fazën e rimëkëmbjes së tij, janë sfidat më të rëndësishme të Samsonit. Harafa, i cili arrin i pari te Samsoni, i thotë atij se kishte dëgjuar mjaft lajme për bëmat luftarake të izraelitëve dhe tani kishte ardhur “për të parë se prej nga kishin ardhur ato lajme” Ai e shpreh keqardhjen që s’janë ndeshur më parë në fushëbetjë, në mënyrë që të mbronte lavdinë filistine, por tani mjerisht: Ai nderë,/ Me siguri është fituar nga ti,/ Në dyluftimin për jetë a vdekje,/ Dhe unë e humb betejën meqë të kanë verbuar.

Reagimi i shpejtë i Samsonit ndaj kësaj sfide qyqare, shfaqet me guximin e tij për përleshje individuale me viganin filistin. Mirëpo, Harafa, i cili kishte ardhur vetëm për ta qesëndisur e ngacmuar, trembet nga sfida e guximshme dhe menjëherë përpiqet të arsyetohet, duke thënë se kinse fuqia e Samsonit buronte nga magjia.

Pothuajse, i pavetëdijshëm Samsoni ia kthen: Unë s`di gjë për magjitë, s`përdori truke,/ Mbështetëm në Zotin e gjallë,/ I cili më pajisi me këtë fuqi kur linda...

Provokimet e Harafës, pothuajse në mënyrë të pavetëdijshme i dhanë Samsonit një fije shprese, optimizmi dhe dinjiteti. Kjo është rrezja e parë e shpresës në këtë fazë<sup>12</sup>.

Por, si filloi të interesohej më tepër për aspektet shpirtërore sesa për ato kohore dhe fizike të gjendjes së tij, ai e kishte të hapur derën për kthimin e besimit. Provokimet e Harafës, ia kishin

<sup>11</sup> Po aty

<sup>12</sup> Po aty

zgjuar besimin e heshtur në mëshirën e Zotit dhe shpresën për “ndjesën përfundimtare”. Samsoni kishte besuar gjithmonë në drejtësinë hyjnore. Që nga fillimi, ai kishte marrë përgjegjësi individuale për gjendjen në të cilën ndodhej. Mirëpo, meqë mendimet e tij kishin qenë të përqëndruara më shumë rreth vetës së tij (rreth krahasimit të asaj se kush ishte dhe kush kish qenë dikur), ai zuri të dyshonte dhe të zhgënjehej, duke pandehur se Zoti e akordonte drejtësinë me mëshirën. Por, tani i nxitur nga arsyeja e shëndoshë dhe i prekur në sedër më tepër nga qesëndisja e fjalëve ngacmuese të Harafës (se si Zoti e kishte braktisur atë për shkak të krenarisë së tij), Samsoni përgjigjet se nuk kishte shkak të dyshonte as në mëshirën e Zotit dhe as në mundësinë e ndjesës nga Zoti.

Pa lejen e Zotit, ai e sfidon Harafën në përleshjen për jetë a vdekje, në mënyrë që më tej, të shihej se Zoti i kujt është Zot i vërtetë. Megjithatë, sfida e tij mospërfillëse e sjell atë në zgripçë të kryerjes së një akti tjetër të mendjemadhësisë, duke sakrifikuar përparimin shpirtëror, të cilin e kishte arritur përmes një akti të shkujdesur, por kuptimplotë. Gufimi i papritur i krenarisë së tij si për ironi, e pengon atë në jetësimin e kanosjes së tij mendjemadhe. Ai s`ka dëshirë të luftojë si “mburracak”, që përdor çdo lloj arsyesimesh për t`iu shmangur përleshjes. Harafa nuk mund të luftojë me një të verbër dhe nuk mund ta përulë dot veten për të dalë në duel me një rob. Ndërsa, Samsoni me përbuzje e hedh poshtë kapardisjen filistine me reagim të rreptë: Shporru or qyqar para se të të sulem/ Kështu i prangosur dhe me shpirt të bezdisur,/ Dhe para se me një goditje të të dërrmoj...

Funksionimi i provokimit të Lajmëtarit në njëfarë mënyre e mëson Samsonin sesa nevojë ka ai për durim, qëndresë dhe vetëpërmbajtje. Kori për Samsonin e verbër beson se: Mund të radhitet me ata/ Të cilët më në fund/ Duhet t`i kurorëzojë durimi.

Si dihet, Lajmëtari mbretëror hyn në qelinë e Samsonit dhe i jep urdhër që të vijë pas tij në Tempull, ku po mbahej kremtimi për nder të Dagonit, Perëndisë filistine. Megjithëse, Samsoni i mbetet besnik ligjit izraelit dhe këtë e ka arsye për refuzim, duket sheshit se refuzimi i tij është i motivuar edhe nga sedra dhe krenaria e fyer: A nuk kanë ata lojtarë me shpatë dhe çdo lloj/ Atletësh, mundësish, kalorësish, vrapuesish,/ Zhonglerësh, vallëtarësh, aktorësh, imituesish,/ Por duhet të më marrin të lidhur me pranga,/ Të rraskapitur nga puna,/Për t`i argëtuar me verbërinë time?

Edhe kësaj radhe Samsoni dukej se po bënte një vepër për një arsye të gabuar, ndërsa kur Lajmëtari ia rikujton se ai duhet të dëgjojë urdhërin për hir të sigurisë së tij, Samsonit i kujtohet se siguria e tij nuk është aq me rëndësi, sepse ai e ka fuqinë dhuratë nga Zoti, veçanërisht tani kur ka falje për ndjesë dhe nuk do të bënte të njollosej e të koritej: “Me pjesëmarrjen dhe lojën e tij para perëndive të tyre”.

Prandaj, Samsoni me atë rast, refuzon ta zbatojë urdhërin e Lajmëtarit, meqë e ka të qartë se duke vepruar në atë mënyrë, do ta shkelë ligjin e Zotit dhe do ta njollosojë “dhuratën e përkushtimit”. Ai vetë mund të vendoste me këtë rast. Meqë kishte të drejtë për zgjedhje, mori vendimin: Për të zbatuar urdhërin e sundimtarëve filistinë/ Urdhërat nuk janë detyrime. Nëse i zbatoj,/ Këtë e bëj me dëshirë pa u hamendur.

Ky është një konfirmim i besimit dhe përunjësisë së Samsonit, prandaj në fund ai e parapëlqen vlerën superiore. Ai vendos ta respektojë urdhërin e Zotit pa i marrë parasysh pasojat për të. Mirëpo, ai shkon edhe më tutje, sepse ai shpall se Zoti: Mund të disponojë me mua dhe me ty,/ Të pranishëm në tempullin e riteve pagane...

Ai nuk do të zbatojë urdhërin e filistinëve, por: “Në qoftë se”, thotë ai, “Zoti urdhëron” që ai të jetë i pranishëm në tempullin pagan, ai do ta dëgjojë urdhërin e Zotit pa ngurrim dhe pa mëdyshje. Mirëpo, në atë çast ende nuk e kishte marrë atë urdhër, prandaj nuk e dëgjoi urdhërin e

Lajmëtarit filistin. Më në fund e kishte të qartë se mund të shërbejnë dhe të jenë besnikë edhe ata “të cilët qëndrojnë dhe presin”.

Asnjëri në dramë nuk i kupton tërësisht arsyet e vendimit të Samsonit, meqë në atë çast ai ishte plotësisht i izoluar nga të gjithë, por jo edhe nga Zoti. Derisa të mos vendos Zoti ndryshe, Samsoni kishte vendosur t’i kalojë ditët duke pritur me durim; ai është bërë më në fund hero i vërtetë. Duke mësuar dhe duke marrë porosi e mësim nga përvojësia, pendesa, besimi dhe durimi, Samsoni ishte këndellur dhe shenjtëruar: “Si me shpirt ashtu edhe me trup... për t’u vënë në shërbimin e Zotit dhe të veprave të mira”. Pikërisht në këtë moment, në pikën kulminante të këndelljes së përvojës së tij, Samsoni me anë të “impulsit intim”, vetëdijësohet për misionin e tij të veçantë, të lartë dhe hyjnor. I udhëzuar nga Shpirti i Zotit tani ai është i gatshëm që të shkojë pas Lajmëtarit mbretëror: Unë do të shkoj me Lajmëtarin,/ Dhe ta dini se/ S`do të bëj asgjë që e cenon kanunin tonë...

Ai nuk i di hollësitë e detyrës së tij me të cilën e ngarkon Zoti nëpërmjet Lajmëtarit, mirëpo ishte i vetëdijshëm për rëndësinë e misionit të tij nga “ndjenjat e shqetësuara”. Ishte i bindur se Zoti e kishte pranuar përsëri në shërbimin hyjnor, kështu që misioni i tij i profetizuar ishte që ta shprehë këtë përmes një veprave lavdiplote, e cila ndoshta mund të jetë e fundit. Tani karriera e tij po e mbyllte rrethin e vetë, ndërsa Samsoni përsëri ishte bërë mbrojtësi besnik i Zotit, i nënshtruar me besim të thellë në vullnetin ende të pazbuluar të Zotit të tij të hyjnueshëm, prandaj i shkon pas Lajmëtarit në celebrimin e Dagonit, për të plotësuar misionin e tij të martirit.

Samsoni me ndihmën e Zotit, përfundoi një transformim shpirtëror, që i bëri të mundur t’i shporrej skllavërisë, mëkatit dhe vdekjes. Jo vetëm kaq, ndërsa Manoa dhe Kori bëjnë fjalë për përpjekjet e Manoas për ta liruar të birin përmes shpërblësës me para, Samsoni në të njëjtën kohë e kryen aktin e fundit të jetës dhe e siguron lirinë e tij fizik nga robëria e tij filistine, duke bërë metamorfozën e tij shpirtërore dhe misionin e tij të parashikuar e profetizuar për çlirimin e Izraelit nga sundimi filistin.

As Kori e as Manoa, nuk mund të marrin pjesë drejtpërsëdrejti në misionin madhor të Samsonit, i cili ka një shkallë më të lartë të mirëbesimit se të tjerët. Mirëpo, ata besojnë se në karrierën e Samsonit gjendet një analogji e një niveli më të lartë sesa që mund të bëjnë ata. Këtu është edhe shembulli i heroizmit shpirtëror, i cili shërbyesin përgjegjës e shpëton nga burgu i mëkatit dhe vdekjes. Në vargjet e fundit, Lajmëtari i përshkruan hollësisht rrethanat e vdekjes së Samsonit. Ai rrëfen se përkundër përbuzjes dhe indinjatës që shpërthyen posa ai u paraqit, Samsoni nuk humbi dot as durimin, as dinjitetin dhe as guximin.

Akti i shembjes së tempullit është një akt nergut i zgjedhur, një veprim i lirë në të cilin vullneti i bërësit bashkëpunon dhe njëherësh i nënshtrohet vullnetit të Zotit. Përveç kësaj, megjithëse as Samsoni dhe as personazhet tjerë s`janë të vetëdijshëm për këtë, akti i mbrojtësit të Izraelit pajtohet me disa vlera të caktuara. Qëndrimi i tij në tempull, krahët e shtrira drejt shtyllave masive, e paralajmërojnë ngjarjen e mëtejme, kurse çlirimi fizik, paralajmëron çlirimin e popullit izraelit dhe përfundimin e misionit të Mesias. Anëtarët e Korit dhe të fisit Danitas, kuptojnë se Samsoni: I gjallë apo i vdekur, e kishte përmbushur/ Misionin ndaj Izraelit për të cilin ishte zgjedhur.

Kështu që, Kori dhe Manoa e çmojnë faktin se ai nuk vdiq i poshtëruar ose pa heroizëm, por vdiq si një shërbyes i Zotit, i udhëhequr nga “qëllimi i pakontrolluar i tij”. Ata po kështu, nuk janë të vetëdijshëm për madhësinë e ngjarjeve, të cilat i dëshmojnë, prandaj me gjithë ironinë e pavetëdijshme, do të artikulojnë ndjenjën e tyre të atij çasti, përmes një imazhi, të cilin brezat e ardhshëm do ta përmendin vetëm për ringjalljen: Por ndonëse i verbër,/ I përbuzur dhe pothuajse i molitur,/ Me syrin e ndezur të shpirtit,/ U ringjall virtyti i zjarrtë i tij,/ Nga hiri dhe flaka e papritur,/ Sikurse ai zogu që vetë lind,/ Në pyjet legjendare të Arabisë,/ Të cilin rrallëkush e njihet./

Nga hiri u vetëngrit, i ringjallur,/ I këndellur dhe i përtrirë,/ Kur dukej se kishte mbaruar,/ Dhe me gjithë se Zogu vdes,/ Fama i mbetet e mbetet edhe,/ Zogu shekullor i epokave. Feniksi i Korit, është një zog vital i ngritur në një realitet të lartë dhe në legjendë. Manoa e shikon vdekjen e Samsonit nga një këndëshikim më praktik. Por, edhe ai me vizionin e tij të kufizuar, gjen ngushëllim në një shkallë të guximit shpirtëror: Samsoni ndërroi jetë,/ Si i ka hije Samsonit,/ Dhe ia solli Izraelit:/ Nderin dhe lirinë, e të tjerët/ Le të marrin si shembull trimërin e tij,/ Për veten dhe për lavdinë,/ E shtëpisë së përjetshme të Zotit...

Këtyre dëshmitarëve u duket se këndellja e virtyteve të Samsonit e ktheu atë në vendin e merituar, si “mbrojtësin besnik të Zotit”. Sipas tyre, fitorja e tij si shpirtërore, martire ashtu edhe fizike, kishte rëndësi si fitorja mbi lulen filistine. Me një mirëkuptim dhe ndjenjë të qëllimit fetar, të frymëzuar nga përvoja e përsosur e Samsonit, Kori izraelitë thotë lamtumirën në fund të dramës: Çdo gjë është më së miri,/ Ndonëse ne shpesh dyshojmë,/ Në atë që s’është hetuar,/ Në mençurinë më të thellë,/ Që kemi afër nesh,/ Dendur e fsheh fytyrën,/ Por befas i kthehet mbrojtësit të tij besnik,/ Për t’i sjellur dëshmi lavdiplotë.

### 3. Njësimi dhe pleksja e traditës klasike dhe biblike në dramën “Samson Agonistes”

Miltoni kishte ndërmend që “Parajsa e humbur” të jetë një fitore e krishterë mbi zhanrin epik klasik, ndërsa shembëllyeshëm me “Samson Agonistesin” e paramendonte ngadhnjimin e krishterë mbi zhanrin e dramës klasike. Në letërsinë klasike në përgjithësi, si dhe në jetën dhe kulturën antike në veçanti, sipas Miltonit ka dy elemente. Një element është zhvillimi i aftësisë së natyrshme njerëzore apo si mund ta quajmë “imagjinatës krijuese”, jashtë zbulësës së krishterë që posedon jo të vërtetën e zbulësës, po një analogji ose një paralele me të vërtetën. Megjithëse, poezia e Biblës, sipas pamfletit të tij “Arsyet e qeverisjes kishtare”, është një poezi më e mirë se poezia klasike, kjo e fundit është një model frymëzues më i sigurt për ata poetë, të cilët nuk janë të sigurt se kanë një frymëzim të lartë.

Mirëpo, për fat të keq, kultura klasike nuk është vetëm një zhvillim njerëzor. Njeriu pa zbulësë ose pa të vërtetën e Zotit, sipas fesë së krishtere nuk mund t’i shmanget versionit djallëzor apo ndonjë parodie të asaj zbulëse. Së këndejmi, format e këtilla letrare sikundër që është eposi homerik dhe tragjedia e Sofokliut, janë modele të vërteta të stilit, të bukurisë dhe të “lirisë antike”.

Në veprën e Miltonit “Parajsa e rifituar”, një epikë e shkurtër për të cilën Miltoni nuk përmend ndonjë model klasik, ndjenja e parodisë bie në sy më së tepërmi. Krishti ia del mbanë të përballojë të gjitha tundimet apo sprovat e Satanës, ngase ai e ka fare të qartë se çdo gjë që ofron Satana i ka rrënjët nga e keqja e mallkuar demoniane. Këtu çështja është më se e qartë, ngase Krishti refuzon kategorikisht çdo mundësi të lidhjeve me Satanën. Hedhja poshtë e traditës dramatike angleze nga Miltoni në parathënien e “Samson Agonistit” është më vështirë të kuptohet. Tema e “Parajsës së rifituar” sipas kritikës së arketipit, është një parodi e përrallës për vrasjen e kulshedrës, apo paraqet përrallën e vrasjes së kulshedrës si një lloj parodie.

Edhe në “Parajsën e humbur” për të cilën mund të thuhet se është një epikë e modelit të Homerit dhe e Virgjilit, ndjenja e parodisë bie në sy më shumë sesa sensi i analogjisë. Epika klasike, është një poemë e aksionit heroik si “Klea androni”, apo “trimëritë e trimave”. Mirëpo, krishterizmi ka një koncept tërësisht të kundërt të heroit. Heroi i krishterë është ai i cili e imiton ose i përmbahet heroizmit të Krishtit, i cili përbëhet nga vuajtja, mirëkuptimi, stoicizmi, toleranca, durimi dhe mëshira. Si duket, në mendjen e Miltonit janë sajuar pikëpamjet e tij për heroizmin e krishterë ashtu si e parashikon në traktatin e tij “Arsyeja e qeverisjes së kishës” dhe në poemën “Parajsa e humbur”. Në këtë poemë të fundit, ndërkaq heroizmi konvencional i etikës



klasike i mvishet Satanës dhe djajëve të tjerë. Ç`është e vërteta, në qiell zhvillohet një luftë e hatashme në të cilën engjujt besnikë tregojnë trimëri të rrallë, por kur në ditën e tretë, i Biri i Zotit i qëron hesapet me tërë grupin e rebelëve fillikat vetëm, ndjenja e parodisë merr një theks të veçantë. E tërë përlëshja që zhvillohet në qiell, është një lojë e Zotit për të cilin nuk ekziston asnjë fuqi tjetër pos fuqisë së tij. Një ndjejnë e identitetit të fuqisë dhe të vullnetit hyjnor, së bashku me mungesë të çdo fuqie tjetër, paraqitet edhe te poema “Komus”, ku vëllau i madh, shpjegon se si ndershmeria e Shën Mërisë është një fuqi e pacënuar dhe e pamposhtur si edhe në rrëfimin e Samsonit, ku Samsoni vret njëmijë filistinë me ashtin e nofullës së gomarit.

“Parajsja e humbur” shndërron kriteret klasike dhe pagane në kriteret të krishtera si tek ngjarjet që shpalosen ashtu edhe në shpalimin dhe në artikulimin e heroit<sup>13</sup>. Për Miltonin, i vetmi akt i ndershëm dhe i vërtetë është akti i cili bëhet me vullnetin e Zotit. Kur Adami e ha pemën nga Druri i dijes, ai nuk kryen një akt, por bën një pseudo-akt të mosndërgjegjës. Po kështu, rebelimi i Satanës ishte një akt i parodisë së rebelimit. Të vetmet veprime të njëmendëta në “Parajsën e humbur”, janë aktet e krijimtarisë dhe të shëlbimit, që i kryen i Biri i Zotit. Nëse parimi i njëjtë vlen edhe për “Samson Agonistesin”, atëherë fare lehtë do të kuptojmë konceptin e Miltonit për veprimin tragjik. Në të vërtetë, asgjë nuk ndodh askund pos sëndërtimit të vullnetit të Zotit. Në botën e engjuve të njeriut kjo mund të shihet lehtë si një provani e drejtë njerëzore, në botën shtazore nën njeriun mund të konsiderohet si një lloj pasqyre e saktësisë automatike të instiktit. Meqë vepra e Zotit është relativisht e qartë në këto botë, atëherë nuk ka mundësi për ndonjë veprim tragjik, si i duket Miltonit, as mes engjuve besnikë, e as mes shtazëve. Edhe në jetë po ashtu është e vërtetë, se nuk ndodh tjetër përpos vullnetit të Zotit apo provanisë. Provania e Zotit mund të shihet në arsyen njerëzore, por arsyeja është një kritikë e shtypur dhe e nënshtruar e diktaturës së pasionit, prandaj shpesh nuk respektohet. Jeta njerëzore krijon vazhdimisht ngjarje, të bëmeritë dhe festa të shfrenuara në kundërshtim me vendimin e Hyjnisë në të cilën të ligët prosperojnë, kurse të mirët ndiqen dhe poshtërohen.

Për t`i kuptuar të gjitha këto, duhet pritur Gjyqi i fundit në fund të jetës, qoftë i një jete individuale apo edhe historisë njerëzore, në mënyrë që të del në shesh se e mira shpërblehet, kurse e liga damkoset dhe dënohet. Mirëpo, edhe sipas filozofisë antike herë pas here, të ligët ballafaqohen me shkatërrime të tmerrshme, me ç`rast arsyeja e tyre kujton se rrënimi i tyre është pasojë e marrëzisë ose vrazhdësisë së tyre të mëparshme. Të mirët, pikërisht, pse janë të mirë, zakonisht kanë vështirësi dhe peripeci në shoqërinë njerëzore. Fati i tyre normal herë përqeshet e herë injorohet, kurse ata madje martirizohen. Njeriu i mirë, ose profeti, është një mjet i dukurive të çuditshme në shoqërinë njerëzore dhe i vullnetit të Zotit, i cili vepron kundër të këqijave njerëzore, kurse jeta e tij mund të jetë edhe tragjike.

Me sa dihet Miltoni e konsideronte si tragjike sa herë që i shkante mendja te Beltezari (figurë biblike), ose rasti i Jobit biblik, duke kujtuar se i këtillë ishte reagimi i vullnetit të Zotit në jetën njerëzore, kundër fuqisë së pasionit të verbër njerëzor dhe mëkatit. Në këtë kontest, për Miltonin tragjedia është njohja dhe përqaftimi i vullnetit të Zotit në përputhje me drejtësinë dhe ligjin. Si drejtësi e përligjur është edhe parimi i barazisë, kurse vizioni tragjik ka për pasojë barazinë ose drejtpeshimin, të cilin Aristoteli e quan “katarzis”<sup>14</sup>. Sipas shpjegimit të katarzisë nga Miltoni, në

<sup>13</sup> Po aty

<sup>14</sup> Fermor, U.E.: Samson Agonistes and Religious Drama in, The Frontiers of Drama, Methuen and Co. LTD, Suffolk, 1967, fq. 34-56; Abrahams, M.H., Tragedy, in A Glossary of Literary Terms, Penguin Books, London, 1982, fq. 294-5 dhe fq. 703-711; Shipley, T.J., Classicism, Tragedy, in Dictionary of World Literature, Littlefield Adams, New York, 1966, fq. 58-62 dhe 419-423; Zhivkoviq, D., Klasika Anticka Tragedija, në Recnik Knjizevnih Termina, Nolit, Beograd, 1992, fq. 355-357 dhe 870- 878. Veçanërisht relevante është studimi Frye, N.: The Great Code, The Bible and the Literature, Harcourt B.J- Routledge and Kegan Paul, New York, 1982

parathënien e tij të “Samson Agonistesit”, pasojat e pasionit njerëzor nuk mund të merren si tragjike nga njerëzit, por vetëm nga arsyeja njerëzore, e cila i shporret epshtit të pasionit pasi që ka zbuluar një pasion e virtut më të madh. Me një fjalë, në shpirt zakonisht mbisundon pasioni mbi arsyen, kurse në tragjedi pasioni merr formë të veçantë, të cilën mund ta njohë vetëm arsyeja. Në këtë mënyrë, pasoja e katarzisë është që të transformojë shpirtin duke ia kthyer arsyes epërsinë dhe duke e dëbuar epshtin me pasionin fisnik<sup>15</sup>.

Sipas të gjitha gjasave edhe në tragjedinë klasike janë dy rrafshet të veprimit tragjik. Rrafshi më i ulët është ai në të cilin shkatërrimi është konsequenca e pashmangshme e marrëzisë ose keqbërjes, për të cilën ekziston fjala “nemezis” në tragjedinë greke. Ky lloj i tragjedisë së nemezisit i ka ngjarë Samsonit para se të fillojë Samson Agonistesit; i takon edhe dramës të cilën Miltoni ia dha titullin “Samson Hybristes”. Në dramën të cilën e kemi sot, veprimi i nemezisit është aksioni tragjik që i dëmton filistinët. Vetë Samsoni kalon nëpër fazën e dëlirjes shpirtërore ose shëlbimit, në të cilën ai pranohet edhe njëherë si shërbyes i mëshirës dhe i vullnetit të Zotit dhe mbrojtës i Izraelit. Së këndejmi, ndonëse në mënyrë të pashmangshme ngatërrohet me vdekjen tragjike, për këtë vdekje nuk është tanimë aq me rëndësi koncepti i nemezisit. Tragjeditë e filistinëve dhe të Samsonit janë elemente të paradisë djallëzore, nga njëra anë dhe të analogjisë me aksionin tragjik, nga ana tjetër. Ajo që u ndodh filistinëve është e njëjta ngjarje që u ndodh edhe heroit Ajaks të Sofokliut ose Heraklitit të Euripidi, ku shkaktarët e katastrofës finale janë djajtë. Nga ana tjetër, Samsoni është analogjia njerëzore e Krishtit, vdekja e të cilit është pak a shumë prototip i vdekjes së Krishtit. Është më se e qartë se epiqendra e aksionit tragjik është “Dhiata e vjetër”, ku lexuesi apo publiku i krishterë, mund të gjejë llojin më madhor e më të lartë të tragjedisë me një prespektivë të vërtetë, si pjesë përbërëse e analogjisë së ligjit të shenjtë.

Mirëpo, duhet thënë se ky koncept i rrafshëve të aksionit tragjik paraqitet në tragjedinë greke me qartësinë më të plotë në fund të veprës “Orestit” të Eskilit. Këtu gjendet ndikimi i nemezisit i përfaqësuar nga furitë (perenditë e hakmarrjes), të cilët nuk janë në gjendje të dallojnë elementet e drejtësisë në situatën tragjike, si bie fjala përmasat, cilësinë dhe llojin e sfidës së viktimës, por janë shprehje e lirë e një fuqie thelbësisht të vetëvetishme, janë rregulluesit e drejtpeshimit të trazuar në natyrë<sup>16</sup>. Kjo lëvizje e nemezisit tejkalohet nga mendimi legjitim, me të cilin parashihet bashkëveprimi i perendive dhe njerëzve dhe në të cilën vizioni më i lartë tragjik, mbaron me shfaqimin e Orestit, njëlloj si në dy dramat për Edipin e Sofokliut. Në dramën e parë të tij, “Edipi tiran”, Edipi i shkull sytë e tij me njëfarë refleksi plotë indiferencë dhe neveri ndaj tmerrit dhe llahtarit, pa qenë i vetëdijshëm se ngatërrimi i tij i pavetëdijshëm në këtë, ka një ogur dhe domethënie të veçantë etike. Zhvillimi i ngjarjeve të Edipit tiran kalon nëpër fazën e vetë të shpalimit, e cila rrjedh së prapthi në kohë dhe mbaron me reagim dhe veprim. “Samson Agonistesit” i Miltonit fillon në drejtimin e kundërt, në saje të një progresi që e shpie përpara vetëshpalimin retrospektivë të tij dhe e largon atë nga verbëria. Kjo tragjedi, në të vërtetë mund të krahasohet deri në një shkallë me vargun e ngjarjeve të subjektit të tragjedisë së dhjetë të Sofokliut, “Edipi në kolonë”.

Ne më parë hasim në Samsonin të përfshirë në vorbullin e nemezisit, të torturuar nga furitë mekanike të ndërgjegjës së tij. Është e ditur se etika e krishterë e dallon gjithmonë vrasjen e ndërgjegjës nga pendesa. Si rrjedhojë, ndonëse Samsoni është penduar me të vërtetë, përsiatjet, hamendjet dhe shestimet e tij, të cilat janë një lloj vrasje e ndërgjegjës, mbisundojnë që në fillim, ndërsa trupi i Samsonit është mbushur me parazitë dhe papastërti. Ndaj, edhe ndotja mendore e shkaktuar nga Zoti i insekteve (djalli Belzebub), të cilin e përmend Harafa, e bezdisin, e ndotin

<sup>15</sup> Fermor, U.E., vep. e cituar 40- 48; Shipley, T.J., vep. e cituar, fq. 421. Zhivkoviq, D., vep. e cituar 874

<sup>16</sup> Fermor, E.E., po aty

dhe e turbullojnë mendjen e tij, duke krijuar kështu diçka që dëshmon se Miltoni kishte lexuar për torturat e Prometheus: O mendime, o torturuese të mia,/ Të armatosura me thumba vdekjepruese/ Ju po i dërrmoni gjymtyrët e mia më të brishta.

Samsoni është tunduar dhe ka humbur davanë, kurse si rezultat i këtij dështimi ia beh posedimi dhe ndikimi demonian. Kori është i trallisur nga fakti se Samsoni është më i lig sesa ata. Si duket kemi të bëjmë me një lloj ritmi të depresionit nga nemezisi që parashikon se ata që janë më të mëdhënjë e më të lartë, e kanë rënien më të rëndë. Kjo ka të bëjë mjaft me ritmin e rrotës së fatit në tragjedi, e cila i ka magjepsur shkrimtarët e Mesjetës: Ajo jo vetëm që po i dërrmon ato./ Që bredhin në jetën e errët, në rrëmuje,/ Por i hedh më poshtë lartësitë e tua. Porositë e këtyre vargjeve të fundit do të na kthenin tek “Libri i Jobit” nga Bibla. Por, pjesa e përgjigjes është se të zgjedhurit e Zotit janë të prirur të mëkatojnë ashtu siç nuk mëkatojnë njerëzit e rëndomtë. Kjo vlen pikë së pari për Adamin, në Kopshtin e Parajsës, për të cilin edhe një gabim më i thjesht, sipas kriterëve të rëndomta njerëzore, merrej si mëkati më i madh. Megjithatë, as Adami s’mund të gremisej dot aq thellë si djajtë e mallkuar, të cilët rroposen nga një lartësi akoma më e lartë. Parimi i njëjtë vlen sipas analogjisë edhe për filistinët. Hakmarrja hyjnore, në radhë të parë bie mbi kokat e krerëve të parisë dhe të priftërinjëve. Në rrënimin e tempullit të tyre: “Vetëm njerëzit e rëndomtë shpëtuan, ata që kishin mbetur jashtë”. Ritmi i rrotës së fatit për ta mund të dëgjohet nga efektet e zhurmës që arrijnë jashtë skenës, nga brohoritja për fitoren e izraelitëve dhe rënkimi e gjama në agoninë e vdekjes së filistinëve, që ushtojnë larg ndërsa rrota e fatit bënë një gjysmë harku.

Po kështu, në fillim të dramës, Samsoni është një rob dhe i lidhur me pranga të jashtme e të brendshme. Pos që është “në mulli”, me robët tjerë ai gjindet në të njëjtën kohë në burgun brenda burgut, ose si thotë edhe vetë Kori: “Në burgun e vetës tënde”. Megjithatë, ai e konfirmon lirinë e tij shpirtërore, duke e refuzuar pjesëmarrjen në kremtimin filistin në fillim, por duke pranuar me kënaqësi rastin që ia jep Zoti, që të shkojë në festë në tempull më vonë. Në tempull ai bën disa shestime, të bëma dhe veprime në pajtim me urdhërin e Zotit. Ndërkaq, aktin kryesor të misionit e bën sipas dëshirës dhe vullnetit të vetë të lirë. Njëlloj, megjithëse vetëdija e tij përmban edhe një dritë të brendshme, ashtu si pohon Miltoni në veprën e tij “Mbrojtja e dytë”, ai është i vetëdijshëm si thotë Kori: “Se ai nuk rrezaton më rreze të dikurshme”.

Por, në aksionin e tij të fundit, si konfirmon Kori: “Shikimi i tij i brendshëm ndriçoi. Në “Librin e gjyqtarëve”, lutja e fundit e Samsonit është: “O Zot, lermë të vdes me filistinët”. Miltoni nuk e citon këtë drejtpërsëdrejti, edhe pse është kjo tema e bashkëbisedimeve të Samsonit me Manoan. Ky varg biblik na dëshmon se Samsoni është i gatshëm për vdekje. Ky përmallim është edhe një lloj dëshprimi, por Zoti ate e shndërroi në një arritje heroike dhe ngadhnyese që përfundon me vdekje. Zoti në këtë mënyrë përdorë parimin e vetëshërimit, dhembjen e shëron me një dhembje tjetër, e cila është pjesë e katarzisë të tragjedisë. Sa më tepër që Samsoni i shporret nemezisit, aq më tepër makineria e nemezisit kalon te filistinët. Ata pajisen me “hubrisin” (shpirtin e furisë) që është kushti normal dhe veçori e heroit të tragjedisë greke.

“Shpirti i tronditjes” shoqërohet me dehjen, harenë dhe kënaqësitë e filistinëve që janë në kundërshtim me gjendjen e Samsonit, i cili pi vetëm ujë. Ngjarja ndodh në mëngjes, por në shënime të Miltonit në “Librin e arsyes”, njerëzit të cilët pihen, zakonisht mund të dehen edhe pa ndihmën e verës. Kjo dehje është një dehje dioniziane, një ekstazë hyjnore nga Perëndia apo nga ai, të cilin ata e konsiderojnë si Perëndi. Në Bibël thuhet se mjekra dhe leshërat e Samsonit zunë të rriten përsëri, ndërsa ai ndodhej në shtëpi, në burg të filistinëve. Ka disa të dhëna të rritjes së leshrave në disa përralla popullore, por mund të shtrohet ndoshta edhe pyetja, meqë filistinët e zbuluan sekretin e fuqisë së Samsonit, pse i lejuan t’i rriteshin leshërat përsëri? Miltoni jep një përgjigje. Në përgjigjen e tij thuhet se pronarët e mullinjëve fitonin mjaft para duke shfrytëzuar

punën e tij që vlente më shumë se shumë krahë pune. Përgjigja e dytë është se filistinët besonin me të vërtetë në fuqinë e Zotit të tyre Dagon, prandaj edhe besonin se fuqia e Samsonit nuk mund të rritej dhe të bëhet e rrezikshme për ta. Pikërisht ky besim i tyre i veçantë, ishte “shpirti i tronditjes së tyre”.

Në “Biblën e Mbretit Xhejms” thuhet se Samsoni kishte marrë urdhër që t’i dëfrente filistinët në këtë mënyrë ai përfitoi nga rasti për ta rrënuar Tempullin. Në një edicion të ri të Biblës në anglishte thuhet se Samsonin e kishin detyruar të luftonte si gladiator deri në vdekje. Ky koncept me siguri nuk do t’i pëlqente Miltonit. Nga aspekti dramatik Samsoni do ta dobësonte kulmin e fuqisë së tij duke vrarë ndonjë filistinët. Ajo që është me rëndësi, pohon Miltoni, është se në çastin që Samsonit iu këndell fuqia e vërtetë atëhere asnjëri s’guxonte të matej me te. Së këndejmi, edhe Harafa e ka parasysh këtë fuqi të Samsonit. Modeli për karakterin e Harafës është i biri i tij Goliati, ndërsa Goliati mburrej orë e çast, meqë si dihet luftetarët e zakonshëm, hera herës e fitonin betejën e tyre me mburrje, megjithatë nuk ka shenja se ai është qyqar. Ai e pranon mbretin Saul që të dalë në dyluftim me të, kurse Sauli për të cilin thuhet se ishte si vigan në Izrael. Gjatë bisedës me Harafën, Samsoni papritmas e rikonfirmon rolin e tij si mbrojtës i Jehovait, kurse Harafa nuk guxon që të shtyhet me të. Ai s’do mend, mund të ketë qenë qyqar, por me këtë rast ate mbase e ka frenuar diç tjetër e jo qyqarësia e tij.

Është shumë me rëndësi për qëllimin dramatik të Miltonit që Samsoni të paraqitet në Tempull, si një lloj dëfryesi, pothuajse gaztori ose palaçoje në karnevalin filistin, një Agonistes (Luftëtar) në kuptimin e aktorit, por jo si garues për ndonjë shpërblim, ngase zakonisht ai s’dilte në gara me askend. Njëkohësisht, ai është një hero tragjik, një kampion i dëshpruar dhe një luftëtar për pasuesit e tij danitas. Ngjarjet rrjedhin rrëmbimthi, kurse tragjedia arrin kulmin dhe shndërrohet në një triumf, kurse karnevali përfundon nën rrënoja. Pikërisht në këtë rol dhe në këtë aspekt, këto situata e bëjnë Samsonin një prototip të Krishtit, ngaqë edhe Krishti është hero për ithtarët dhe besimtarët e tij; edhe ai është një figurë që u përqesh, u shpotit dhe u fye në karnevalin e armiqëve, ndërsa goditje e ngjashme gremisëse i ndodhi edhe Atij.

Në “Samson Agonistesin” përmbysja dhe kthesa janë artikuluar përmes përfytyrimit kompleks të dritës dhe errësirës. Miltoni e dinte mjaft hebraishten për të mos u ndikuar nga “shemeshi” (fjala hebraishte për diellin) në emrin e Samsonit, e ndoshta ka gjetur diçka si një mit në formën e diellit në rrëfimin për heroin leshgjatë, i cili kishte rënë në errësirën e burgut në përfundim. Drama hapet me lindjen e diellit dhe me Samsonin e lirë në natyrë, por njësoj si titanët tjerë, përfshirë Prometheun, në fund të dramës së Eskilit, ai simbolikisht gjendet në një burg nëntokësor (ose në një shpellë), ndërsa disa aluzione të rralla klasike në dramë tërthorazi, aludojnë në figurën e Atlasit dhe Iksionit. Kihet përshtypja se Samsoni ose fuqia që e drejtonte Samsonin po lëvizte nën botë, sikurse lëviz dielli natën për t’u kthyer në vendin e lindjes. Zhvillimi i ngjarjeve papritmas mbaron në mesditë, kur kulminacioni i ngadhënjimit filistin pa prituri e pa kujtuar, bëhet copë e thërrime nga shpërthimi i flakës së errët e të fshehur, që u ngrit nga hiri si zogu i Feniksit. Nga këndshikimi i izraelitëve, kjo do të thotë se eklipsi i plotë nga i cili ankohet Samsoni ishte ngritur dhe megjithëse ai përpigjet ta mbulojë fytyrën e tij me duar, dielli Perëndi i vërtetë papritmas ishte kthyer<sup>17</sup>. S’ka pikë dyshimi, se “Samson Agonistes” është një dramë e njëmendët me sfondin, atmosferën, fabulën, personazhet e vërtetë dhe dialogjet e monologjet. Ajo madje mund të përgatitet e të shfaqet me sukses para publikut. Mirëpo, Miltoni kishte thënë se nuk e kishte shkruar për shfaqje, e cila deklaratë shpesh lidhet me paragjykimet e puritantëve ekstremistë në Angli. Si dihet, ky paragjykim nuk është aq i rëndësishëm për Miltonin, megjithatë pas paragjykimit, qëndronte tradita e puritantëve.

---

<sup>17</sup> Shipley, T.J., po aty

Në këtë botë konflikti esencial në mes të mirës dhe të keqës e merr formën orale të konfliktit ndërmjet fjalës dhe orakullit, mes gojtarisë së vërtetë dhe të rrejshme. Sidoqoftë, pikësynimi i çdo gojtarie false është imazhi vizual që kërkon dëgjuesë jo ndaj Zotit por ndaj diçkafi tjetër. Kështu, në “Parajsën e humbur” Jezui arrin në shkretëtirë pa pasur ndonjë imazh vizual për ta hutuar apo për ta larguar atë nga angazhimi në betejën mortale me fjalët e rrejshme të paditësit. Mirëpo, Satana është në gjendje të përdorë vetëm disa halucinacione vizuale. Sikur Krishti t’i pranonte këto halucinacione, ai përnjëherësh do të identifikohet me to d.m.th. me metamorfozat e djallit. Por, ai i bëri ballë të ligës. “Samson Agonistesi” përmban një konflikt paralel midis fjalës së Perëndisë së Samsonit, që ishte mbështetja e fundit e fuqisë së tij dhe të tundimeve të paditësit që e kanë formën e një varg dialogjeve. Rëndësia e këtij aspekti të konfliktit është njëra ndër gjërat që e simbolizon vërbëria e Samsonit. Samsoni jeton në një botë të zërave të shkëputura shpirtërore ndërmjet mullirit me skëllevërit, që punojnë në të, dhe të Tempullit me praninë e krerëve dhe me prijtarë të filistinasve; ai i thotë Korit: “I dëgjoj tingujt e fjalëve të tyre; por kuptimin e tyre ndonëse ajri e shpërndan, megjithatë nuk i zuri veshi im”.

Gjithësecili që flet me Samsonin, Manoan dhe Korin ka për t’i shtuar ndonjë qortim atij, për të dhënë ndonjë sugjerim të mosbesimit dhe të pasigurisë. Edhe të dëgjuarit e Samsonit duhet të frenohet: ai mund të shkëpusë marrëdhëniet me Dalilën vetëm duke mos i futur veshët në lesh. S’do mend se, në tragjeditë greke e kishin si traditë përqëndrimin rreth dialogut, me ç’rast fundi tragjik shpallet nga kasnecët; por megjithatë drama greke me sfondin e saj të amfiteatrit dhe me maskat është një përvojë mjaft intensive dhe vizuale, ashtu si na përkuqton edhe fjala greke “teatër” (që d.m.th veprim). Aksioni apo veprimi i dramës së Miltonit sikurse edhe veprimi në “Librin e Jobit” formon një lloj antidrame vizuale. Në këtë kontekst, ajo i anticipon disa veçori të teknikës së dramaturgëve të mëvonshëm, të cilët po ashtu shpesh janë quajtur puritanë si p.sh. Bernard Shoi. Në përgjithësi ajo lloj drame duket si njëfarë debati i ngjarjes së të kaluarës dhe të ardhmës pa ndonjë aksion, pos atyre aksioneve për të cilët dëgjohet jashtë skenës. Ç’është e vërteta, ngjarja është e pranishme, por është një lloj aksioni i çuditshëm për përdorim të brendshëm, kështu fjala edhe vjen veprimet ose ngjarjet e rëndësishme duken të padukshme në mendjen e Samsonit.

Ndërkohë, si na rrëfen fabula e kësaj tragjedje, filistinët ishin duke përgatitur celebrimin e tyre të Dagonit. Ajo ndërtesë mund të quhet Tempull dhe pikërisht atë Tempull e shemb Samsoni, ngase simbolikisht aty celeburohej edhe kulti i Perëndisë së Dagonit. Mirëpo, mund të supozohet se e njëjta godinë ishte edhe teatër, si e quan edhe Kasneci, por nuk ishte një teatër i modelit Athinas, por një teatër për argëtim si e cirkut të Romës antike. Këshilli i programit filistin nuk e kishte paralajmëruar pikën më atraktive deri në çastin e fundit, prandaj edhe në fjalët e paraqitësit të programit, ka mjaft fjalë të paqarta, kapardisje, dokërra dhe premtime. Kështu, Samsoni largohet nga një veprim për të cilën kishte vrarë mendjen për një copë kohe dhe i detyrohet të paraqitet në teatër si i verbër, i paaftë për t’u zbrapsur, para syve të tërë shoqërisë filistine; me një fjalë, ai ishte bërë epiqendra e Gazës. Por, përnjëhershë ai përsëri është mjet dhe shërbyes i Zotit, kurse në shoqërinë filistine ishte shumë e rrezikshme nëse do t’i binin në fije qëllimit të tij.

Theksimi vizual prej të cilit brengoset Miltoni barazohet me idhujtarinë e mundshme, e cila ekziston si në kohë ashtu edhe në hapsirë. Në kohë ajo merr formën e ankthit të vazhdimësisë, që krijon jo vetëm doktrinën e trashëgimisë apostolike në kishë, por edhe parimin e trashëgimisë familjare në shtet. Besimi se të gjitha marrëveshjet bashkëshortore duhet të trajtohen si të paprishura, është një rrjedhojë e ankthit të njëjtë. Trashëgimia apostolike, e zëvendëson trashëgiminë shpirtërore të atyre, të cilët i fton Zoti për t’i shërbyer përherë njerëzimit. Trashëgimia sipas radhës po kështu, shkatërron parimin hyjnor të të zgjedhurve. Mbreti i

njëmendët, sikurse edhe profeti, paraqitet kur Zoti e thërret atë. Trashëgimia e krerëve dhe e profetëve është e pavazhdueshme sipas rrethanave – kushteve njerëzore dhe asnjë metodë njerëzore nuk mund ta ruajë atë. Kështu, sipas paragrafit hyrës të “Ungjillit sipas Mateut”, Jezui e kishte prejardhjen prej Abrahamit dhe Davidit, përmes babës së tij Jozefit, megjithatë Jezui nuk ishte i biri i Jozefit. Samsoni ishte njëri ndër heronjtë e radhës i ftuar nga Zoti kur populli i tij iu kthye dhe filloi ta respektonte Zotin pas një periudhe të apostazisë ose të largimit nga rruga e Zotit. Ftesa e tij paraqitet nëpërmjet një tregimi të bukur të shpallur në “Librin e gjyqëtarëve”, i cili përfundon me engjëllin që kthehet në qiell mbi zjarrin e një altari. Ky imazh, i cili dy herë përmendet në “Samson Agonistesin”, shndërrohet në imazhin e zogut të Feniksit, apo në imazhin e trashëgimisë hyjnore të fuqisë së vetme të ringjalljes nëpërmjet vetëflimit që nuk mund të parashikohet nga asnjë institucion human.

Një ndër dramat e cila mund të ketë lidhje me “Samson Agonistesin” është drama “Atali” e Rasinit, e cila është një tragjedi tjetër e shënuar e shekullit të XVII-të, me temë dhe subjekt nga “Dhiata e vjetër”. Lidhjet mes këtyre dramave mbështeten kryesisht në kontraste, sepse Atali është një dramë mahnitëse me një mori personazhesh dhe karakteresh. Sikurse që do të vepronte Bajroni më vonë, në një mënyrë krejt tjetër. Rasini mendon se “Dhiata e vjetër” nuk është një shkretëtirë e ligjit, por një burim i shkëlqimit magjeps të Orientit. Në dramën “Atali” është pleksur edhe çështja e trashëgimisë sipas radhës përmes princit të Joash Xhuash, i cili i takon familjes së Davidit dhe ka farifisni me Krishtin. Ndoshta vetëm me këtë rast Rasini i përngjan Shekspirit, kronikat historike të të cilit në mënyrë të veçantë e vëjnë në dukje rendësinë e madhe të trashëgimisë sipas dinastisë. Rrëfyesi biblik jep një vërejtje të këtillë për anarkinë që pasoi pas Samsonit: “Në ato ditë nuk kishte mbret në Izrael; secili bënte ç`ti tekej”<sup>18</sup>.

Në “Dhiatën e vjetër” megjithatë nuk është e qartë në është e dobishme apo jo mbretëria e trashëguar për Izraelin, por lavdia e Mbretërisë së Davidit e të Solomonit janë ngjarje që nuk harrohen, prandaj lexuesi fare lehtë do të shoh te këto figura mbretërore prototipat e Krishtit, si monarkë të vërtetë dhe legjitim të botës. S`ka dyshim, se dallimi në mes të individit dhe profesionit të tij të cilin Miltoni shpesh e përmend në pamfletet e tij me porosi mbretvrasëse, rrjedh nga qëndrimi i “Dhiatës së vjetër” ndaj mbretërve. Në veprën e tij “Arsyeja apo pushteti kishtar” gjendet një pasazh i gjatë alegorik ku përshkruhet mbreti si një Samson i parë me një imazh me leshra, që është jehonë e Samson Agonistesit. Ky përfundim duket i qartë dhe na lë të kuptojmë se Samsoni, përderisa ishte një lider i zgjedhur nga Zoti, nuk ishte vetëm një mbret legjitim, por në të njëjtën kohë kishte fuqi për të vendosur mbretërinë e Zotit në tokë, me ç`rast fuqia e tij hyjnore nuk kishte fund. Një gjë e këtillë vërehet edhe nga vërejtjet që i bën Kori Samsonit: Por ti me fuqinë tënde,/ Me virtytin që i përkiste njeriut/ Do të mund ta nënshtroje Tokën,/ E të kurorëzohesh me madhështi.

Mirëpo, Samsoni nuk e kreu misionin e tij si një arritje, e cila mund të krahasohej ose të kundërvihej me atë të Krishtit. “Parajsa e humbur” rrëfen tregimin për atë se si njeriu e humbi Kopshtin e Parajsës aq të shtrenjtë për të dhe se si nga ana tjetër atij iu dha mundësia që të rikthehej në atë Kopsht nëpërmes gjendjes së tij shpirtërore. Ndërkaq, te “Parajsa e rifituar” Krishti, duke i bërë ballë me këmbëngulje, provokimeve dhe tundimeve të Satanës, në mënyrë simbolike e shndërron shkretëtirën në një Kopsht të Parajsës, pikërisht ashtu si na shkruan në poemën e shtatë të kësaj vepre. Mirëpo, imazhi dhe metafora e Kopshtit të Parajsës gërshetohet

---

<sup>18</sup> Shih edhe Bonnet, J.S.: A Reading of Samson Agonistes. In the Cambridge Companion to Milton. Ed. Dennis Danielson, New York, Cambridge University Press, 1994; Harris, W.O.: Despair and Patience in “Samson Agonistes”, in Critical Essays on Milton from EHL, Baltimore, John Hopkins University Press, 1969

me atë të Tempullit, që është imazhi qendror i ligjit të Izraelit, të cilin Krishti jo vetëm që e nderon, por edhe e tejkalon në ngjarjet e kësaj poeme. Miltoni i përmbahet versionit të “Ungjillit për Llukën” kur flet për tundimin, kur Krishti vendoset në kulm të Tempullit nga Satana dhe kur citohen disa psalme që sugjerojnë se nëse ai bie nga kulmi i Tempullit, nuk do të lëndohet fare. Por, Krishti mbetet i qetë dhe i palëvizshëm në maje të Tempullit, që do të thotë se Tempulli i njëmendët i Zotit kishte hyrë në trupin e tij, duke u shndërruar në një Tempull, që mund të ngritet përsëri edhe pasi të rrënohet në kundërshti me Tempullin e Herodit, nën të cilin u shkatërrua njëherë e përgjithmonë pas disa vitesh. Samsoni duke shkatërruar Tempullin demonian dëshmon dukurinë se çfarë mund të bëjë njeriu vetë për shëlbimin e përsëdytshëm të tij. Njeriu nuk mund ta shndërrojë veten në një qenie superiore apo ta shëlbjë veten; por ai mund ta shpreh vullnetin e tij duke i rrënuar idhujt rrotull tij. Ajo që arrihet me këtë mund të jetë negative dhe ikonoklastike, por megjithatë nuk është një arritje e kotë: tregon ndarjen mendore nga natyra të njeriut para se ai t`i bashkohet Zotit. Konform me këtë pikëpamje, Samsoni është ai i cili e sëndërton parashikimin e Psalmës 91, të cituar nga Satana, ngase megjithëse ai rrëzohet nën Tempullin dhe vdesën, suksesi i tij është i akseptueshëm nga Provania (Zoti).

Rrëfimet për Samsonin në “Librin e gjyqëtarëve” janë deri diku barbare dhe primitive edhe në kontestin e krijimit të tyre. Kori e lavdëron tepër virtytin kryesor të Samsonit të mospirjes së verës, por Kori e lavdëron edhe hapjen me dhunë të portës së Gazës nga Samsoni me qëllim që të vuajë atje. Pothuajse, në të gjitha tregimet dhe motivet që kanë të bëjnë me Samsonin dhe Dalilën, rolin e Samsonit e luan një katallan, ose një vigan kanibal, i cili nuk i pëlqen askujt; mahitë vdekjeprurëse dhe brutale që Samsoni ua bën filistinëve, sipas të gjitha gjasave, e kanë zgjuar admirimin e Miltonit, megjithëse edhe ai deri diku i besonte kallëzimit biblik. Miltoni na rrëfen se Samsoni, ndërsa po përpiquej që t`i prekte shtyllat e Tempullit: Po qëndronte si dikush që thoshte urata/ Ose si t`i kish shkrepur diçka e rëndësishme/ Në mendjen e tij.

Nga “Libri për gjyqëtarët” dimë se subjekti i përsiatjes së tij ishte lutja për hakmarrje individuale, mirëpo kjo u desht që të evitohet sepse asnjë katastrofë që ka të bëjë me vullnetin e Zotit, sipas Miltonit, nuk mund të ndodhë pa iu përmbajtur aksiomës së urtë se: “Hakmarrja më përket mua”, e cila i takon një morali shumë më të lartë sesa qëllimi dhe morali i Samsonit biblik. Për Miltonin, “Dhiata e vjetër” është ligji i Librit hyjnor, dhe është një e vërtetë e jashtëzakonshme të konstatohet se si i krisuri i tërbuar i “Librit të gjyqëtarëve” është zbutur aq tepër nga Miltoni, sa që ai gjen rrugën e papritur të ligjeve të etikës. Vlerat më të mira të caqeve të dëgjesës civile ndaj një fuqie shpirtërore armiqësore, bie fjala, të obligimeve të gruas ndaj burrit me kombësi dhe fe tjetër, të raportit të një veprimi të qëllimshëm që shpie te një vetëvrasje vullnetare, të dallimit midis urdhërit dhe përmbajtjes, ngriten, trajtohen dhe shkoqiten me një mjeshtri të rrallë në këtë dramë, kryesisht nga vetë Samsoni. Fjala e greqishtes antike “agon” përdoret në ligjet e vjetra, me ç`rast fjala “Agonistes” do të thotë mbrojtës, përkrahës, garues, luftëtar. Ky aspekt i Samsonit ka të bëjë me metaforën legjitime në “Bibël”, sipas së cilës koncepti i shëlbuesit rrjedh nga fjalët që e kanë domethënie të tyre në gjykime.

Samsoni është i shtërnguar që rrugën e tij nga robëria në liri të arrijë përmes ligjit hyjnor dhe së këndejmi, ai deri diku në mënyrë të përmbledhur e artikulon programin e Miltonit të përgatitur për popullin anglez. Çështjet dhe temat kryesore që paraqiten në bisedat e Samsonit me Manoan, Dalilën dhe Lajmëtarin filistin, janë çështje që kanë të bëjnë me fenë, me atdheun dhe lirinë qytetare. Që nga fillimi Samsoni dallohet dukshëm nga pasuesit e tij, të cilët e parapëlqejnë “robërinë në rehati sesa lirinë, e cila arrihet me mundime”. Me fjalë të tjera, ky është një paradoks pothuajse ekstrem që e bën Samsoni, i cili është i dënuar si rob në truallin filistin, ndonëse tani është më afër lirisë sesa që do të ishte sikur të jetonte në rehati dhe qetësi në shtëpinë e tij; por ky është, sipas Miltonit parimi i lirisë sipas Zotit, prandaj ky parim duhet të jetë

i vërtetë. Kështu, propozimi i Manoas, i bërë nga dashuria e sinqertë ndaj Samsonit, është një sprovë mjaft e brishtë dhe e rrezikshme, ngaqë përsëritet edhe nga Dalila qëllimkeq. Dalila, s`do mend, paraqet një rrezik për lirinë e atdheut, për arsye të martesës së saj me një idhulltar të një feje tjetër. Bibla nuk e trajton Dalilën si grua të Samsonit, mirëpo në veprën e Miltonit ajo duhet të jetë grua e cila do t`i arsyetojë argumentet për shkurorëzim të Miltonit. Ndërhyrja e Lajmëtarit mbretëror e sjell dialektikën e lirisë në një botë ku s`ka Zot ose, në një fokus dramatik. Përderisa, filistinët janë padronët jofetarë të kësaj bote, ata kanë të drejtë që të kërkojnë nënshtrim; por, kur filistinët i japin urdhër që ai t`u bashkohet në adhurimin e Dagonit, ata nuk kanë të drejtë. Në atë çast Samsoni e ka të qartë se ata i japin urdhër që t`u bashkohet në një ngjarje fetare, prandaj refuzon menjëherë të marrë pjesë në te.

Samsoni ka bërë atë që ka mundur ta bëjë, prandaj e ka arritur qëllimin e tij. Sikur që dihet, gjatë takimit të tij me Harafën, Samsoni e konfirmon përsëri veten si mbrojtës të Jahovait, kështu që Harafa ikën jo mbase pse ishte qyqar, por më parë për shkak se vendimi i Samsonit ishte pranuar nga Zoti. Samsoni është sikurse Jezui në “Parajsën e rifituar”, njeri nën komandën e Ligjit hyjnor deri në një shkallë, për shkak të betimit të tij si nazaritas. Atë që mund të bëjë ndonjë personazh i “Dhiatës së vjetër” dhe që mund ta marrë lirinë të veprjës në emër të Zotit është kur Zoti zbaton ligjin e vetë dhe i nxitë të zgjedhurit e tij që të veprjnë njëllor. Martesa e parë e Samsonit me gruan nga Timnah ishte një leje e këllillë e Zotit. As Miltoni dhe as Bibla nuk konfirmojnë se edhe martesa e tij me Dalilën ishte bërë me lejen e Zotit, por nëse ishte bërë me lejen e Zotit, atëherë ky veprim i Samsonit mund të krahasohet me rastin e Hozeas, të cilit i është dhënë urdhëri që të martohej: “Me një grua nga kurvëtorja”, e pastaj “Të shkonte përsëri” dhe të dashuronte një grua të pabesë. Fakti se Zoti e kishte marrë në mëshirën e tij Samsonin përsëri shënohet nga një ndërhyrje tjetër e Zotit, kur Zoti e merr nën kontrollin e tij vullnetin e Samsonit dhe ia ndërron mendjen atij për pjesëmarrje në festivalin e filistinëve. Natyrisht, ky çast po ashtu dëshmon se Samsoni do të vdesë, pikërisht sikurse edhe çasti kur Krishti ngadhënjën mbi Satanën në “Parajsën e rifituar” e konfirmon njëherësh kryqëzimin. Prandaj, ky çast nuk është vetëm kriza e veprimit, por është edhe peripecia apo pika kthesë e tragjedisë. Samsoni pohon: Nëse i zbatoi urdhërat e tyre,/ Këtë e bëj lirisht duke e sfiduar,/ Vullnetin e Zotit dhe frikën e njeriut nga Ai;/ E njeriu parapëlqente ta harroj Zotin;/ Por me xhelozinë e tij,/ Kurrë s`do të gjejë falje mëkati;/ Por ja ku të them se Zoti/ Na ka në dorë mua dhe ty,/ Në tempujt e riteve të adhurimit;/ Për të na dhënë misionet të rëndësishme.

Fjala “por”, mund të jetë peripecia më e saktë e tërë vargut të ngjarjeve të dramës. Një ndryshim tjetër që e bën Miltoni në personazhin e Samsonit është raporti i tij ndaj shoqërisë. Në letërsinë kreshnike, ekziston shpeshherë tensioni narrativ e nganjëherë edhe tensioni moral ndërmjet temave të luftës dhe misionit të caktuar. Ta zëmë se në një vend dikund zhvillohet një betejë e madhe, në të cilën kanë për detyrë të marrin pjesë trimat ose heronjtë, mirëpo me atë rast kryeheroi, prania e të cilit është e nevojshme për sukses, është tërhequr nga aksioni dhe është i angazhuar në ndonjë veprimtari private. Raporti i Akilit në “Iliadë” ta rikujton mjaft tonin e përgjithshëm të rrëfimëve për Samsonin në Bibël. Njëllor është edhe situata e heronjëve të Ariostos, autorit të epikës “Orllandi i tërbuar”. Në këtë vepër heronjtë, të cilët duhet të marrin pjesë në mbrojtjen e Parisit kundër të pafeve, bredhin në viset e ndryshme të botës, duke i shpëtuar bukuroshet dhe duke bërë aventura të ndryshme.

Ndërkaq, te Miltoni, të gjitha veprimet dhe aktet e Samsonit janë në kuadrin e një fushate të fuqishme në favor të popullit të zgjedhur të Zotit, kundër armiqëve të Zotit. Kur Kori qorton se: “Por, Izraeli ende mbështetet në të gjithë bijtë e vet”, Samsoni përgjigjet: “Unë s`e pranoj këtë gabim”, dhe vazhdon të tregojë se gabimi i popullit të tij për të shkuar rrugës së tij ishte po aq i rëndësishëm sa edhe disfata e tij. Kur Kori i shqetësuar e shfaq brengosjen e vetë pas largimit të



Harafës, si dhe pas daljes së Lajmëtarit, Samsoni i qetëson ata me maturi dhe gjakëftohësi, me ç'rast qëndrimi i tij provon se ai është udhëheqës i lindur, përkundër zheleve, papastërtisë dhe prangave.

Roli i Samsonit si udhëheqës sqaron shumë gjëra lidhur me "Samson Agonistesin", duke filluar me datën, e cila sipas disave është më e hershme se viti 1660. Vdekja e Samsonit, megjithëse tragjike ka një domethënie për botën mbi tragjedinë; shkatërrimi i aristokracisë së Gazës, ndonëse tragjike ose së paku edhe "e trishtuar", si thonë Manoa është diçka që ndodh në botën nën te. Midis këtyre është dështimi tragjik i Izraelit për ta luajtur me dinjitet rolin e tij si popull i zgjedhur i Zotit. Në shumë tragjedi gjindet çasti jotragjik i ikjes gjatë veprimit ose rasti fatlum për të shpëtuar nga rroposja ose përmytja, ndërsa mungesa e këtij çasti përbën një pjesë të parabolës në formën e tragjedisë prej nga zë fill katastrofa apo përmyllja. Aty kah fundi i dramës Manoa thotë se Samsoni: I ka bërë Izraelit një nderë/ Dhe ia ka sjellë lirinë,/ Tani të tjerët do të përfitojnë nga ky rast.

Tragjedia e Izraelit dhe e fisit danitas në veçanti, është një alegori e tragjedisë së popullit anglez, i cili "kishte zgjedhur një kapiten për "Egjiptin e lashtë", si pohon Miltoni në pamfletin "Rruga e gatshme dhe e lehtë" në anglishte, duke hequr dorë me qëllim nga fati i tyre madhështor. Vetë identifikimi i Miltonit të verbër, i cili jeton i izoluar dhe i vetmuar pas Restauracionit me Samsonin e verbër, është më se i qartë. Mirëpo, mund të ketë edhe identifikim edhe me Manoan plotë shpresë më parë por pastaj, shumë të zhgënjyer, veçanërisht nëse e marrim parasysh imazhin e madh në veprën e tij "Areopagjika". Pikërisht kështu, e përfytyron Manoa Samsonin, i cili ishte këndellur për mrekulli dhe ishte forcuar sikur verbëria e tij të kishin qenë një ëndërr e keqe. Në "Samson Agonistesin" neve jo vetëm që na vihet në dijeni rrëfimi origjinal për Samsonin, por përmendet edhe fakti se ajo që kishte ngjarë kishte qenë një episod i rëndomtë në historinë e Izraelit. Një brez pas vdekjes së mbrojtësit të madh të fisit danitas, fisi në fjalë pushoi së ekzistuari.

Danitasit në "Samson Agonistesin" sikurse edhe miqtë e Jobit, përfaqësojnë një lloj norme morale, sepse janë në anën e drejtë dhe shpalohej prej një veprimi për të arritur në thellësi dhe në një fund spontan, por sikurse edhe shumë nxënës të tjerë të Jezuit, kurrë nuk e kanë të qartë domethënien e ngjarjeve në të cilat janë ngatërruar. Ata funksionojnë si sytë për Samsonin, por nuk shohin atë që sheh ai.

Nga pikëpamja e Korit, ngjarja e dramës është një melodramë, ku protagonistin kryesor është Jehovahi, kurse antagonistin i ligë është Dagoni. Jehovahi është Zoti i vërtetë. Në një mënyrë apo në një tjetër, filistinët duhet ta kuptojnë këtë; po ashtu, në një mënyrë apo në një tjetër ata duhet të pranojnë si argument të sigurt shpjegimin e Samsonit për sulmin që bëri kundër tyre: Unë nuk isha individ i vetmuar;/ Por një njeri i ngritur me fuqi të madhe,/ Nën komandën e Zotit,/Për të shpëtuar atdheun tim.

Akti i Samsonit citohet nga Miltoni në parashtresën e tij "Mbrojtja e parë", si një hyrje për revolucionin parlamentar. Kur vetë Zoti është fuqi përkrahëse në histori, atëbotë nuk është vështirë të dëgjohet në prapavijë edhe britma e fuqishme dhe e drejtë: "Çdo gjë që bëjmë ne është e drejtë, sepse ne jemi ne, kurse ata dhe të tjerët fundi fundit, janë vetëm ata". Kundër kësaj është imagjinata krijuese e poetit, duke sendërtuar çdo aspekt të kësaj drame. Kështu, në fjalimin e fundit të Dalilës ne kuptojmë se Miltoni është poet i njëmendët dhe për rolin e Dalilës, pa qenë i vetëdijshëm, meqë ai flet me zërin e saj. Kori thotë me vetëkënaqësi: "Ajo është një gjarpër me helm", mirëpo ne na duhet të kemi një lloj simpatie dramatike për të, në mos edhe simpati morale për Dalilën në përpjekjet e saja të mundimshme për ta rikthyer vetërespektin, pas braktisjes plotë përbuzje nga ana e Samsonit, duke risajuar një lloj përfytyrimi për famën e saj të ardhshme. Ndërkaq, ne kuptojmë se ajo e konsideron veten si një lloj Antigone. Kur ajo përmend

përmendoren që do ta ngrisë për vete duke e paralajmëruar qëllimin e Manoas për të bërë një varr për Samsonin, atëherë ne bashkëveprojmë në një simetri imagjinate, si ndodh edhe në “Parajsën e humbur”, kur Mollohu e bind Sollomonin që t’i ndërtojë atij një tempull përballë Zionit. Kur ajo e krahason veten me Jaelin, ne mund të pajtohemi se akti i Jaelit ishte i pabesë, bile më i gjakftohtë se sa ai i Dalilës. Por, mbi të gjitha kur ajo i drejtohet famës për ta arsyetuar vetën, atëherë shihet qartazi se paku për një çast, ndonëse fama i duket Zotit më arbitrare dhe më e çuditshme, prapëseprap ekziston një lloj drejtësie në qëndrimet e saja që është një qëndrim më i mirë se sa xhelozia e Jehovait.

Miltoni i përshkruan ngjarjet e “Parajsës së humbur” në fillim “si një argument madhështor”, kurse ngjarjet e “Samson Agonistisit” në fund të veprës ai i quan “këto ngjarje të shënuara”. Shpeshherë është ngritur e trajtuar çështja se a mund të përputhet krishterizimi dhe tragjedia, mirëpo çështja e vërtetë nuk është kjo, por është relacioni i tragjedisë me qëndrimin revolucionar. Këtu u bën ca përçapje për shpjegimin e veçorive revolucionare të traditës biblike, të cilave Miltoni iu përmbajt sa pati mundësi si p.sh.: koncepti i tij për Zotin, i cili sipas tij ka një rol historik për çlirimin e popullit nga sundimtarët e tij; pastaj, qëndrimi i tij ndaj “ikonoklastit”, apo kundërshtuesit të besimit të fesë; qëndrimi i tij ndaj besimit të drejtë dhe hedhja poshtë me vendosmëri i të gjithë perëndive, pos perëndive të tij. Mirëpo, është fakt se te “Parajsa e rifituar” dhe “Samson Agonistesi”, në mënyra të ndryshme zhvillohen situata dramatike njerëzore dhe prandaj, këto vepra artikulojnë qëndrime relevante revolucionare, si në kontekstin fetar ashtu edhe shoqëror, të cilët Miltoni i elaboroi, i pasqyroi dhe i përshkoi aq mirë në shkrimet e tij në prozë.

Mendimet revolucionare nuk e hedhin poshtë tragjedinë, por e preferojnë atë, duke e konsideruar atë si diçka të shpjegueshme, si diçka që ka shkakun e brenda mundësive edhe konsekuencën dhe shërimin. “Parajsa e humbur” është pos tjerash një sprovë për ta shpjeguar zanafillën e tragjedisë; ajo shqyrton në një mënyrë më të shkoqitur se sa që do ta bënte Niçe, i cili do ta lidh lindjen e tragjedisë me shpirtin e muzikës. Në “Librin e tretë”, ndërkaq, Miltoni e ve skenën nën urdhërin e engjijve mbi tragjedinë, kur Zoti e shpjegon situatën njerëzore nga ajo prespektivë. Këtu, Miltoni heq dorë nga pikëpamja e tij për fenë, sepse meqë nuk ishte një engjull ai ishte i detyruar të ketë një prespektivë tjetër rivale të botës pagane.

Zoti më suprem i grekëve, prej Homerit e deri te stoikët është një Zot esencial. Ne mund të besojmë se kur Zoti konceptohet si diçka ekzistencialiste, atëherë edhe tragjedia bëhet ekzistencialiste dhe anasjelltas. Në letërsinë greke tragjedia është e pandarë nga jeta njerëzore. Kjo ndodh për shkak se me kohë perënditë mund të mos e përfillin tragjedinë dhe të distancohen nga ajo. Për Miltonin, asnjë vepër tragjike nuk mund të ndodhë pa angazhimin e drejtpërdrejtë të vullnetit të Zotit. Prandaj, për të vullneti i Zotit mund të shpjegohet vetëm në saje të zbulësës së Zotit. Shkrimtarët të cilët s’e pranojnë dot këtë antitezë, sidomos Shekspiri, nuk mund të kenë ndikim vendimtar në formën tragjike të Miltonit, por tragjeditë e Shekspirit nuk janë religjioze në raste të këtilla. Kështu Kori përshkruan në fund të dramës se si ai u pajis: Me një përvojë të re/ Nga kjo ngjarje madhore.

Është e mundur të vihet në dukje edhe një herë se Kori nuk e kupton se çfarë thotë. Ai e sheh në vdekjen e Samsonit pikërisht atë që mund të shihte edhe publiku grek në fund të “Edipit në Kolonë”, si një misterie të thellë dhe të tmerrshme, diçka për të cilën duhet menduar si për një vizion. Ai e sheh dorën e Zotit në te, por afër mendsh duke e thelluar domethënien e misteries. Për Miltonin fjalët “e re” dhe “e vërtetë”, kanë një domethënie më të thellë. Ai beson se përvoja e vërtetë të shpie drejt një veprimi të përtritur, ashtu si e solli përvoja e humbjes së “Lluidasit” mikun e tij: “Nesër në pyje të tjerë në kullosa të reja”.

#### 4. Stili i dramës “Samson Agonistes”

Për stilin e veprës “Samson Agonistis” ka mendime se hera herës fuqia krijuese e Miltonit kishte filluar të shterej. Mirëpo, një gjykim i këtillë është i paargumentuar. Miltoni me qëllim e ndryshoi stilin e “Parajsës së humbur” kur shkroi “Parajsën e rifituar”. Samsoni kërkonte pak a shumë një ndryshim të stilit. Në këtë dramë poetike nuk ka aq mundësi qoftë për përshkrime të hollësishme, qoftë për tingëllimën apo bukurzaninë epike. Dalila në këtë vepër ka kërkuar një përmbajtje edhe më të fuqishme, ndonëse edhe Kori i përpunuar e ka rolin e caktuar në pjesë të ndryshme të veprës<sup>19</sup>.

Në dialog shpesh përdoret stili elokuent dhe lapidar, veçanërisht në pohime, ligjërime, deklarata dhe fjalime. Kështu, Samsoni përdorë një stil të thjeshtë, kur thotë: Ask for the great Deliverer now, and find him, Eyless in Gaza at the mill with slaves. (II. 40-41)/ Kërkoni çlirimtarin e madh tani dhe do ta gjeni/ Të verbër në mulli me robërit. (II. 40-41). Ose me një rast tjetër, ai deklaron: My race of glory run, and race of shame,/ And I shall shortly be with them that rest. (II. 597-8)/ Vrapim im i lavdisë mbaroi e vrapim i turpërimit filloj/ Edhe unë së shpejti ata do t'i shoqëroj. (II. 597-8). Ose me rastin kur Manoa me fjalë të përmbajtura i drejtohet Korit: Nothing is here for tears, nothing to wail/ Or knock the breast, no weakness, no contempt,/ Dispraise or blame, nothing but well and fair,/ And what may quiet us in a death so noble. (II. 1721- 4)/ Asgjë s'është për lot dhe as për vajtim/ Apo për grushtimin e zemrës për dobësinë, për përbuzje/ Për urrejtje dhe për fajësim, por gjithçka është më mirë se s'bën/ Dhe çdo gjë mund të na qetësojë në vdekjen fisnike. (II. 1721- 4).

Ky stil i thjeshtë, i kthjellët, i qartë dhe i pastolisur është stili dominues në dialog dhe dëshmon se Miltoni e çmonte këtë veçori të ngjashme të dramaturgëve grekë. Por, nuk duhet harruar se çdo dramë e mirë përdor një shprehje të drejtpërdrejtë në pjesën më të madhe të saj. Efikasiteti i dramës nuk varet nga një diskurs i jashtëzakonshëm apo i rrallë, por varet nga vendi ku thuhet në kuadrin e një situatë sikurse në vargun çift, të cilin e thotë Kenti në fund të tragjedisë “Mbreti Lir”: I have a journey, sir, shortly to go;/ My master calls me, I must not say no./ Së shpejti zotëri duhet të udhëtoj/ Imzot më thërret, duhet të shkoj.

Mirëpo, pjesa më e madhe e dialogut është një lloj diskutimi, debati dhe zënke; shumë fjalime, ligjërime, batuta, replika e nganjëherë edhe episode të tëra, merren me arsyetimin, kundërshtimin ose përgënjeshttrimin e një mendimi ose të një aksioni.

Stili i Miltonit, është mjaft i përshtatur për zënka, batuata, grindje dhe biseda emocionale. Ai përdor shumë metoda dhe rregulla të gojtarisë latine. Me gjithë praninë e fuqishme të elementit latin, stili i Miltonit ka një liri dhe fuqi të madhe të shprehjes, të cilën mund ta hasësh vetëm te përfaqësuesit e Periudhës Elizabetiane, gjë që i jep vlerë diskursit dramatik të Shekspirin. Njësoj, si Shekspiri, Miltoni herë herë i shkurton, i cënon dhe i shkel rregullat gramatikore dhe shpik e sajton shprehje të reja, të cilat nuk janë krijuar as pesëdhjetë vite pas vdekjes së tij<sup>20</sup>. Ai përfiton si nga asociacionet e fjalëve latine ashtu edhe nga stili i begatshëm elizabetian, për ta pajisur e konsoliduar vazhdimisht stilin e tij me cilësi të rralla.

Miltoni mbi të gjitha i nxit personazhet e tij që të flasin papritmas dhe me një lloj inkoherece, gjë që ndodh edhe në jetën e përditshme përkundër shkathësisë gjuhësore dhe njëtrajtshmërisë së vargut; mendimi dhe emocioni ndikojnë në zhvillimin e fjalive, shpesh duke i cënuar rregullat e

<sup>19</sup> Tillyard, E.M. W., vep e cituar, fq. 286-301; Prince, F.T., 98- 102

<sup>20</sup> Prince, F.T., po aty, fq. 140-141

retorikës dhe logjikës. Me një fjalë, Miltoni e ka prirjen e dramaturgut, e cila është një prirje edhe poetike, për të transmetuar atmosferën disponimin apo emocionin e personazhit në veprimin e ligjërit. Lajkat, vardisjet dhe shprehjet hezituese dhe me ngurrim të Dalilës, gjejnë ekvivalencën e tyre në fjalitë ngurruese dhe ndërduzash të Samsonit, p.sh pas fjalëve plot lajka dhe mëdyshje të Dalilës, Samsoni i përgjigjet: My Wife, my Traitor, let her not come near to me./ Gruaja ime, tradhëtarja ime, mos e leni të më afrohet (Vargu 732).

Përbuzja plot indinjatë ndaj Harafës arrin si reagim ndaj viganit belaxhi. Edhe Kori nuk është më pak dramatik, por jo për shkak të parimit të Aristotelit, të cilit i përmbahet Miltoni. Aristoteli kishte thënë se “Kori duhet të konsiderohet si njëri ndër autorët, dhe si një pjesë e tërësisë, apo edhe pjesëmarrës në veprime”. Kori i Miltonit i kontribuon efektit dramatik me praninë dhe ndërhyrjen e tij të vazhdueshme. Në këtë mënyrë, Kori jo vetëm që tregon mirëkuptim ndaj Samsonit, por edhe paraqet pikëpamje tjetër nga jashtë, gjë që e bën më të gjallë, më të tendosur dhe më tronditëse gjendjen e Samsonit. Stili dhe zhvillimi i veprimeve të Korit ndryshojnë varësisht nga disponimi i protagonistit, kurse Kori e merr temën nga ai, duke ndikuar bashkarisht në rrethanat, atmosferën, mendimet dhe ndjenjat e tij.

Herave të tjera, Kori arrin impulse të njëjta të mendimeve dhe porosive të gërshetuara që janë të mpleksura në dialog. Nganjëherë, Kori lartësohet varësisht nga forma e vargut kryesisht të lirë dhe të vargut të bardhë, duke qenë në gjendje të japë mbresën e ndjenjës së fuqishme që gufon nga kontrollimi i mendimit domethënës. Sa më tepër që ta lexosh “Samson Agonistisin” aq më tepër do ta kuptosh “makinen” dramatike mahnitëse të veprës në të cilën çdo pjesë i kontribuon tërësisë dhe asnjë pjesë nuk mund të gjykohej e izoluar. Veçantitë e stilit të dialogut dhe të Korit, mund të kuptohen vetëm në raport me efektin e arritur në fund të dramës.

## KONKLUZIONI

Në këtë punim janë bërë një varg shkoqitjesh, shqyrtime, dhe interpretimesh të dramës poetike të Miltonit “Samson Agonistes”. Më këtë rast, në fokusin e interesimit dhe të analizës janë vënë si vargu i ngjarjeve tronditëse të fabulës ashtu edhe personazhet, pastaj pleksja e traditës klasike dhe biblike dhe stili i veprës.

Do theksuar se “Samson Agonistes” është një dramë e mirfilltë me sfondin, atmosferën, fabulën, personazhet e vërtetë dhe dialogjet e monologjet. Është interesant se kjo tragjedi na përkujton Miltonin gjatë periudhës së Renesansës. Samsoni i drobitur, i dërrmuar dhe i verbuar, të cilin e kishte tradhtuar gruaja filistine, dënohet me robëri të turpshme nga taborri i armiqëve fitimtarë. Kësisoj i mposhtur ka qenë edhe Miltoni, i cili po ashtu ka qenë i verbër sikurse edhe heroji i tij. Njëherësh, ai ka qenë edhe i dënuar të vuajë në vetmi dhe izolim, derisa armiqet rrotull tij po triumfonin. Këto analogji, për të cilat studiuesit shpesh bëjnë fjalë, janë aq të dukshme sa që nuk duhet dyshuar në karakterin autobiografik të tragjedisë. Por, nuk mund të pohohet se vetëm kjo është e gjithë domethënia e tragjedisë. Ajo shprehje e ndryshimit dhe e evolucionit të brendshëm, të cilin Miltoni e kishte përjetuar gjatë viteve të fundit të jetës së tij, të “Samson Agonistes” shohim si gufinin e energjisë heroike. Si dihet nënshtrimi, paqja dhe besimi i pakundërshtim është në përputhje me parimet e krishterizmit, por nuk përputhej me parimet e autorit.

Miltoni pati sukses në shkrimin e kësaj drame, meqë tema e saj është pikëllimi, vuajtja, mëkati, melankolia, dinjiteti, dënimi dhe misioni i lartë në jetë. Ka të ngjarë se arsyeja e dytë e suksesit të kësaj drame është pikërisht fakti se kjo tragjedi ka karakter autobiografik, ngase duket sheshit se përmes kësaj tragjedie Miltoni rrëfen një fazë të jetës së tij. Kështu, sikurse Miltoni edhe Samsoni kishte luftuar me të tëra forcat kundër armiqëve të tij. Ashtu si kishte marrë Samsoni një

grua filistine dhe ishte penduar e dënuar për të, edhe Miltonit i kishte ngjarë diç e ngjashme. Samsoni ishte verbuar, përbuzur dhe keqtrajtuar nga armiqtë e tij. Këtë ndjenjë e pati si duket edhe Miltoni në fazën e fundit të jetës së tij. Së këndejmi, “Samson Agonistes” duket si një ndër veprat autobiografike më bindëse të njërit ndër shkrimtarët më famëmadhenjë të Letërisë angleze, Xhon Miltonit

## Referncat

<sup>1</sup> Prince, F.T.: Introduction, në Milton, Samson Agonistes, Oxford University Press, Hong Kong, 2000, fq. 13-14

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> Po aty

<sup>4</sup> Po aty, fq. 89-144. Për analiza të mëtejme shih edhe Stein, A., Heroic Knowledge. An Interpretation of Paradise Regained and Samson Agonistes. Hamden, Archon Books, 1965; Radzanovic, M.H.: Samson Agonistes, The Divided Mind in John Milton, Modern Critical Views. Ed. Harold Bloom. New York, 1986; Tillyard, E.M.W., vep. e cituar fq. 282-294

<sup>5</sup> Prince, F.T., vep. e cituar fq. 95-117

<sup>6</sup> Tillyard, E.M.W.: Milton, Pinguin Books, London, 1966, fq. 302-311; Wilson, A.N., The Life of John Milton, Pimplico, London, 2002, fq. 238-9; Shi edhe Prince, F.T., vep. e cituar, fq. 132. Daichies, D., Milton, Hutchinson University Library, London, 1964, fq. 230-248. Lidhur me këtë shih edhe studime të tjera, Hawkins, Sh. H., Samson's Catharsis. In Milton Studies II). Ed. James D. Simmonds. Pittsburgh, University of Pittsburg Press, 1970, Kolbrenon, W., Milton's Warring Angles: A Study of Critical Engagemets, Cambridge, 1997, etj.

<sup>7</sup> Tillyard, E.M.W., vep. e cituar, fq. 304; Prince, F.T., fq. 120-135

<sup>8</sup> Daichies, D., vep. e cituar, fq. 241-2

<sup>9</sup> Po aty

<sup>10</sup> Tillyard, E.M.W., vep. e cituar, fq. 302-310

<sup>11</sup> Po aty

<sup>12</sup> Po aty

<sup>13</sup> Po aty

<sup>14</sup> Fermor, U.E.: Samson Agonistes and Religious Drama in, The Frontiers of Drama, Methuen and Co. LTD, Suffolk, 1967, fq. 34-56; Abrahams, M.H., Tragedy, in A Glossary of Literary Terms, Penguin Books, London, 1982, fq. 294-5 dhe fq. 703-711; Shipley, T.J., Classicism, Tragedy, in Dictionary of World Literature, Littlefield Adams, New York, 1966, fq. 58-62 dhe 419-423; Zhivkoviç, D., Klasika Anticka Tragedija, në Recnik Knjizevniñ Termina, Nolit, Beograd, 1992, fq. 355-357 dhe 870- 878. Veçanërisht relevante është studimi Frye, N.: The Great Code, The Bible and the Literature, Harcourt B.J- Routledge and Kegan Paul, New York, 1982

<sup>15</sup> Fermor, U.E., vep. e cituar 40- 48; Shipley, T.J., vep. e cituar, fq. 421. Zhivkoviç, D., vep. e cituar 874

<sup>16</sup> Fermor, E.E., po aty

<sup>17</sup> Shipley, T.J., po aty

<sup>18</sup> Shih edhe Bonnet, J.S.: A Reading of Samson Agonistes. In the Cambridge Companion to Milton. Ed. Dennis Danielson, New York, Cambridge University Press, 1994; Harris, W.O.: Despair and Patience in “Samson Agonistes”, in Critical Essays on Milton from EHL, Baltimore, John Hopkins University Press, 1969

<sup>19</sup> Tillyard, E.M. W., vep e cituar, fq. 286-301; Prince, F.T., 98- 102

<sup>20</sup> Prince, F.T., po aty, fq. 140-141

## LITERATURA

- [1]. **1. Acinstein, Sh.:** Milton and the Revolutionary Reader (Princeton, NJ: Princeton University Press, 1994)
- [2]. **2. Baker, A. E:** Structural and Doctrinal Pattern in Samson Agonistes.- In -Samson Agonistes- - Twentieth Century Interpretations. Ed. Galbraith Crump. Englewood Cliffs- Prentice- Hall, 1968
- [3]. **3. Bennett, J.S.:** A reading of Samson Agonistes-. In the Cambridge Companion to Milton. Ed. Dennis Danielson. New York- - Cambridge University Press, 1994.
- [4]. **4. Bibla:** Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re, Albanian Bible Society, Tiranë, 1999.
- [5]. **5. Blaimires, H. A.:** Short History of English Literature, Methuen and Co. Ltd, London, 1966
- [6]. **6. Darbshire, H.:** The Poetical Work of John Milton. Vol.I, Paradise Lost, 1952; Vol.II, Paradise Regained, Samson Agonistes and The Minor Poems, 1955.

- [7]. **7. Fish, S.:** “Spectacle and Evidence in Samson Agonistes”, *Critical Inquiry* 15 (1989): 556-86
- [8]. **8. Harris, W O.:** Despair and –Patience as the Truest Fortitude in Samson Agonistes- -. In *Critical Essays on Milton* from EHL. Baltimore- Johns Hopkins University Press, 1969.
- [9]. **9. Hawkins, Sh H:** Samson’s Catharsis-. In *Milton Studies II*. Ed. James D. Simmonds. Pittsburgh- University of Pittsburgh Press, 1970
- [10]. **10. Hoffman, N Y.:** – Samson’s Other Father- The Character of Manoa-. In *Milton Studies II*. Ed. James D. Simmonds. Pittsburgh- University of Pittsburgh Press, 1970.
- [11]. **11. Hudson, H.H.:** An Outline of English Literature, G. Bell and Sons, LTD, London, 1969
- [12]. **12. Kranidas, Th.:** – Dalila’s Role in –Samson Agonistes-. *Studies in English Literature 1500- 1900* 6:1 (Winter 1966).
- [13]. **13. Madsen, W G:** -From Shadowy Types to Truth-. In *Twentieth Century Interpretations of Samson Agonistes*. Ed. Galbraith M. Crumps. Englewood Cliffs- Prentice- Hall, 1968.
- [14]. **14. Martz, L L:** - Samson Agonistes- The Breath of Heaven-. In *John Milton- Modern Critical Views*. New Ed. Harold Bloom. New York- Chelsea House, 1986.
- [15]. **Milton, J.:** *The Poems of John Milton*, Edited by Elend Darbshire, Oxford University Press, Oxford, 1961
- [16]. **Mueller, M.:** Pathos and Katharsis in Samson Agonistes-. In *Critical Essays on Milton* from ELH. Baltimore- John Hopkins University Press, 1969.
- [17]. **17. Radzinowicz, M A:** –Samson Agonistes- The Divided Mind-. In *John Milton- Modern Critical Views*. Ed. Harold Bloom. New York – Chelsea House, 1986.
- [18]. **18. Radzinowicz, M A.:** – Toward Samson Agonistes: The Growth of Milton’s Mind (Princeton, NJ: Princeton University Press, 1978)
- [19]. **19. Stein, A.:** *Heroic Knowledge- An Interpretation of Paradise Regained and Samson Agonistes*. Hamden – Archon Books, 1965.
- [20]. **20. Wittreich, J:** - Calm of Mind- Tercentenary Essays on Paradise Regained and Samson Agonistes in honor of John S. Diekhoff. Ed. Joseph A. Wittreich. Cleveland- Case Western Reserve University, 1971.
- [21]. **21. Wittreich, J:** - Interpreting Samson Agonistes. Princeton- (Princeton University Press, 1986)
- [22]. **22. Worden, B.:** - “Milton, Samson Agonistes, and the Restoration”, in Gerald MacLean, ed. *Culture and Society in the Stuart Restoration: Literature, Drama, History* (Cambridge: Cambridge University Press, 1985), 111-36.